

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”.
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Vendim Nr. 460, datë 29.6.2022 “Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027”; Vendim Nr. 700, datë 12.10.2016, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Konsolidimin e Tokës në Shqipëri”. Programi Qeverisës 2021-2025
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	6.2.2025 - 6.3.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	20.05.2025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po. 12.3.2025
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025-MBZHR-Nr. 3
TË DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Adra Gjongecaj e-mail-i: Adra.gjongecaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0692325402 Entela Kola e-mail-i: Entela.kola@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688535551 Mimoza Shahini

	<i>e-mail-i:</i> Mimoza.Shahini@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0684038791
--	--

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

(Maksimumi 2 faqe)

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i kushton vëmendje të veçantë trajtimit të tokave bujqësore nëpërmjet politikave të saj. Si organ politikëbërës dhe njëkohësisht me funksione monitoruese, ministria i konsideron tokat bujqësore një burim strategjik me rol të pazëvendësueshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë. Megjithë këtë rëndësi, tokat bujqësore kanë qenë të ekspozuara ndaj një sërë sfidash, përfshirë fragmentarizimin si pasojë e strukturës së pronësisë, paqartësinë mbi statusin juridik që shpesh shndërrohet në objekt mosmarrëveshjesh gjyqësore, mungesën e regjistrimit të plotë, ndryshimin e qëllimit të përdorimit, mungesën e infrastrukturës dhe nivelin e ulët të investimeve.

Në vijim listojmë disa nga problematikat e evidentuara:

- Kuadri rregullator i vjetëruar dhe i fragmentuar;
- Investime të reja në nivele të pakënaqshme;
- Statusi i paqartë i pronësisë së tokës bujqësore;
- Pengesa ligjore për veprimtaritë fotovoltaike;
- Ndryshimi i statusit të tokës bujqësore;
- Të dhëna jo të plota kadastrale.

Në Shqipëri ende nuk është zhvilluar plotësisht një treg formal i tokës rurale:

- Vetëm 17% e tokës bujqësore është dhënë me qira nga MBZHR;
- Tregu formal i pazhvilluar.

Procesi i verifikimit të pronësisë dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme në praktikë ka hasur në pengesa. Vështirësitë kryesore lidhen me përdorimin e tokave bujqësore në një kohë kur të dhënat e sakta për regjistrimin dhe pronësinë e tyre mungojnë. Për shkak të këtyre pengesave ka sipërfaqe të konsiderueshme toke që nuk janë të regjistruara në kadastrë ose që rezultojnë me konflikte pronësie, sidomos në zonat rurale dhe ato malore të cilat nuk janë të regjistruara apo të përditësuara në regjistra. Kjo ka krijuar pasiguri juridike për pronarët aktualë ose potencialë të tokave, duke ndikuar negativisht në motivimin për të investuar në to dhe duke penguar zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë. Ndryshimi i statusit të tokës bujqësore në destinacione të tjera është evidentuar prej shumë transaksioneve të regjistruara me objekt tokën bujqësore ku është konstatuar se transaksioni nuk bëhet për qëllime të zhvillimit bujqësor, por për ndërrim të mëtejshëm të destinacionit nga tokë bujqësore në truall për ndërtim apo qëllime të tjera. Urbanizimi,

mungesa e zbatimit të planeve të zhvillimit të territorit dhe presioni për ndërtim në zonat me potencial bujqësor kanë bërë që shumë toka të humbasin destinacionin e tyre fillestar duke sjellë reduktimin e sipërfaqeve bujqësore.

Tokat bujqësore përballen me mungesë të infrastrukturës, si: rrugë, ujë, sistem kullimi dhe akses në energji elektrike sidomos në zonat e thella ose më pak të zhvilluara. Mungesa e infrastrukturës përbën një pengesë me efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e bujqësisë moderne dhe për tërheqjen e investimeve private duke rezultuar në investime në nivele të ulëta. Shpesh fermerët hasin në vështirësi për të çuar prodhimin në treg, duke lëkundur kështu qëndrueshmërinë e aktiviteteve bujqësore në këto zona.

- Kuadri rregullator është i vjetëruar dhe i fragmentuar. Aktualisht evidentohen mungesa të përditësimit ligjor në përputhje me rritjen e teknologjive në treg të cilat paraqesin rëndësi shumë të madhe për zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë si tërësi. Ligjet dhe aktet e tjera rregullatore ekzistuese janë shpesh të bazuara në politika të miratuara dekada më parë, kur struktura ekonomike dhe demografike e vendit ishte ndryshe. Ndërkaq Ligji Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” është përditësuar vetëm njëherë në vitin 2018, që nga viti 1998 kur ka hyrë në fuqi.

Konkretisht në veprimtaritë bujqësore të lejuara në tokën shtetërore nuk janë përfshirë teknologjitë e përparuara si metoda agrifotovoltaike. Aktualisht, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk jep me qira toka bujqësore, në administrimin e saj, për ushtrimin e aktivitetit fotovoltai. Tokat bujqësore në administrim të MBZHR-së, jepen për aktivitet bujqësor ose agrifotovoltaik dhe jo për ushtrim vetëm të aktivitetit fotovoltai. Kufizimi ligjor i tillë ka sjellë pengesa në zhvillimin dhe përfitimin maksimal nga përdorimi i tokave bujqësore në pronësi të shtetit.

Grupet e prekura nga problematikën e mësipërme janë:

- Qeveria;
- Fermerët;
- Komuniteti dhe shoqëria civile;
- Punëmarrësit;
- Operatorët e bizneseve;
- Prodhuesit e produkteve bujqësore.

Nëpërmjet kësaj nisme synohet shfrytëzimi me efektivitet i tokave bujqësore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përmes përfshirjes në procesin e dhënies me qira edhe të aktiviteteve që lidhen me teknologjitë dhe metodat inovative si metoda agrifotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e tokës, rregullimi i afatit për instalimin e infrastrukturës së prodhimit të energjisë, parashikime për kontratën tip si dhe lloji i bonitetit të tokave bujqësore ku do të lejohen përdorimi i kësaj metode. Përdorimi i këtyre metodave dhe teknologjive të reja do të sjellë rritjen e investimeve dhe të prodhimit bujqësor duke shfrytëzuar dhe vënë në efikasitet toka bujqësore me fertilitet të ulët. Adresimi i problematikave të evidentuara, përmes përditësimit të kuadrit rregullator dhe integritetit të metodave teknologjike inovative lidhur me tokën bujqësore që jepet me

qira nga shteti, ka një rëndësi thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor. Ky proces përbën një nga prioritetet kryesore të politikave të Qeverisë së Shqipërisë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë si më poshtë:

1. Harmonizimi i kuadrit rregullator për qiradhënien e tokave bujqësore me legjislacionin për investimet strategjike dhe rritja e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor shqiptar, brenda vitit 2026;
2. Lehtësimi i procedurave për investitorët strategjikë në sektorin e bujqësisë;
3. Përfshirja e metodave të përparuara (agrifotovoltaike) si veprimtari të lejuara në tokat bujqësore shtetërore;
4. Krijimi i një klime më të favorshme për investimet në bujqësi dhe rritja e produktivitetit bujqësor;
5. Përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve për zhvillimin e teknologjive të reja bujqësore në tokat shtetërore, brenda vitit 2027;
6. Rritja e përdorimit të teknologjive të gjelbra në bujqësi dhe përmirësimi i produktivitetit;
7. Rritja e transparencës dhe efikasitetit në qiradhënien e tokës bujqësore shtetërore;
8. Rritja e dhënies me qira e tokave bujqësore brenda afatit 5-vjeçar, me 5% nga momenti i miratimit të nismës;
9. Rritja me 20% e nivelit të investimeve si rrjedhojë e përdorimit të metodave inovatore nga subjektet private në sektorin bujqësor dhe të peshkimit, brenda një afati prej 5 vitesh nga miratimi i nismës.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë si vijon:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma rregullatore ose jorregullatore, nënkupton lënien pa zgjidhje të problematikave të evidentuara, mosadresimin e tyre dhe mospasurimin me risi të ligjit në fuqi. Kjo qasje nënkupton që nuk do të ketë ndërhyrje në legjislacionin aktual dhe se problemet e evidentuara do të vazhdojnë të mbeten pa zgjidhje. Qëndrimi në gjendjen aktuale do të thotë që ligji ekzistues do të mbetet i pandryshuar dhe që do të injorohen problematikat e vazhdueshme në sektorin e bujqësisë.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri dhe shfuqizimi i ligjit aktual “Ligji Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” nuk është zgjedhja e duhur. Ky opsion nuk është i përshtatshëm, nuk trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh në kohë duke mos dhënë rezultatet e duhura. Ky opsion parashikon miratimin e një ligji të ri dhe shfuqizimin e

ligjit aktual në fuqi. Megjithatë, ky opsion nuk ofron zgjidhje efektive në kohë për problematikat e evidentuara dhe nuk trajton nevojat aktuale të sektorit.

Opsioni 2 - (rregullator): Ky opsion parashikon ndryshime dhe përditësimin e ligjit aktual në fuqi. Rishikimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 8318/1998 synon të sjellë një modernizim të kuadrit ligjor për qiradhënien e tokave bujqësore shtetërore, duke përfshirë teknologji të reja dhe praktika të qëndrueshme bujqësore. Në vend që të hartohet një ligj krejtësisht i ri (siç parashikohet në Opsionin 1) apo të lihet kuadri aktual pa ndryshime (Opsioni 0 - status quo), ky opsion përfaqëson një zhvillim të balancuar, të qëndrueshëm dhe të arritshëm.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të ishte forcimi i zbatimit të ligjit ekzistues në fuqi dhe rritja e llogaridhënies për strukturat kompetente ekzistuese. Trajnimi i stafit, forcimi i kërkesës së llogarisë, monitorimi më i shpeshtë i terrenit etj. Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, trajnimeve për stafin zbatues dhe rritjen e mbikëqyrjes së institucioneve dhe operatorëve të biznesit në këto sektorë.

Pavarësisht sfidave, **Opsioni 2** përfaqëson zgjidhjen më të plotë dhe afatgjatë për trajtimin e çështjeve të zhvillimit të bujqësisë si dhe ai ofron një bazë solide për të adresuar problematika ekzistuese, për të harmonizuar politikat kombëtare me standarde evropiane, si edhe për të ndërtuar një sistem më efikas dhe të qëndrueshëm në fushën e politikës për tokat bujqësore në administrim të MBZHR-së.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni 2 (rregullator): Miratimi i ndryshimeve ligjore ofron kuadrin ligjor rregullator për vënien në efikasitet të tokës bujqësore duke siguruar që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standardet evropiane.

Grupet e prekura:

Projektligji ndikon në mënyra të ndryshme mbi këto grupe:

1. Qeveria:

- nxit punësimin dhe rrit të ardhurat nga qiradhënia e tokës bujqësore në administrim të MBZHR-së,
- rritjen e cilësisë së produkteve bujqësore;
- rritjen e eksporteve të produkteve bujqësore;
- plotëson standardet e BE-së për sektorin bujqësor, duke përmirësuar imazhin ndërkombëtar;
- vënien në efikasitet të tokave me pjellori të ulët do të sjellë rritjen e investimeve dhe të prodhimit bujqësor.

Fermerët:

- duhet të përmbushin masa të reja biosigurie dhe standarde fermash;

- përfitime nga rritja e të ardhurave, standardeve të jetesës, zhvillimi i jetës së zonave rurale, investime më të mëdha.

2. Komuniteti dhe shoqëria civile:

- përfitime sociale përmes modernizimit të sektorit bujqësor dhe përmirësimit të cilësisë së produkteve bujqësore, rritje të ardhurash;
- hapja e vendeve të punës dhe përmirësimi i jetesës në zonat urale;
- modernizimi i bujqësisë dhe diversifikimi i aktiviteteve në zonat rurale;
- transformim të suksesshëm të forcës së punës nga aktivitete të lidhura me bujqësinë drejt atyre jobujqësore;
- përmirësimi i standardeve të jetesës në sektorin rural krijon mundësi punësimi përmes diversifikimit dhe zhvillimit të mundësive për gjenerimin e të ardhurave në sektorin e bujqësisë.

3. Punëmarrësit:

- mundësi të reja punësimi dhe zhvillimi profesional;
- përmirësim i kushteve të punës dhe hapje e vendeve të punës në zonat rurale.

4. Operatorët e bizneseve:

- rritje e marrëdhënieve tregtare;
- rritje e të ardhurave;
- mundësi për kryerjen e eksporteve në masë më të lartë;
- cilësi më e lartë e produkteve bujqësore.

5. Prodhuesit e produkteve bujqësore:

- shtim i prodhimit;
- cilësi më e lartë;
- pajisje dhe mjete më të përshtatshme moderne;
- konkurrueshmëri më e lartë në tregun e brendshëm por edhe atë evropian.

Ndikimet kryesore të projektligjit:

1. Sociale:

- nxit rritjen e jetesës përmes punësimit dhe zhvillimit rural;
- modernizimi i industrisë përmirëson dhe rrit cilësinë e tokës bujqësore duke ndikuar në rritjen e dhënies më qira të tokave bujqësore në administrim të MBZHR-së, sigurinë ushqimore dhe ofron produkte bujqësore më cilësore dhe prodhimtari me të madhe, ushqim me cilësi më të lartë për kafshët e fermave për mbarështim dhe therje;
- përfitime për komunitetet rurale nga zhvillimi ekonomik dhe social.

2. Ekonomike:

- rritja e eksportit dhe zhvillimi i tregtisë forcon ekonominë kombëtare;
- investimet në standarde dhe teknologji krijojnë kosto fillestare, por përkthehen në përfitime afatgjata për sektorin privat dhe atë shtetëror;
- rritja e tregut të punës në bujqësi nxit investime të huaja dhe rrit të ardhurat e qeverisë.

3. Mjedisore:

- zhvillimi i sektorit bujqësisë përmes përfshirjes së metodave teknologjike inovative sjell përfitime jo vetëm në sektorin e bujqësisë por edhe jashtë tij në

zonat rurale duke u përqëndruar më shumë në ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm;

- përdorimi i teknologjive të avancuara redukton konsumin e energjisë dhe ndotjen mjedisore;
- zbatim të Kushteve të Mira Bujqësore dhe Mjedisore (KMBM) të thjeshtuara, përveç standardeve minimale ligjore dhe të cilat do të jenë të detyrueshme për përfituesit e mbështetjes së të ardhurave dhe pagesave kompensuese e që synon të kontribuojë në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në mbrojtjen e ujit, tokës dhe biodiversitetit.

Kosto dhe Përfitime:

- **Kosto të Sektorit Privat:** Përfshijnë investime fillestare për përmbushjen e standardeve, modernizimin e teknologjisë dhe trajnimin e personelit.

Edukimi dhe trajnimi mund të paraqesin kosto pasi inovacionet teknologjike kërkojnë një nivel të caktuar njohurish dhe aftësish nga fermerët. Gjithashtu, mund të paraqitet nevoja e caktimit të një tekniku për teknologjitë që do të përdoren dhe kjo shton nevojën për punëmarrje shtesë për fermerin. Për të realizuar potencialin e plotë të teknologjive inovative në bujqësi, është e rëndësishme të investohet në edukimin e fermerëve, të mbështetet kërkimi shkencor dhe të krijohen politika që inkurajojnë adoptimin e teknologjive të reja. Prandaj, programet e edukimit dhe trajnimeve janë të domosdoshme për të maksimizuar përfitimet nga këto teknologji.

- **Përfitime të Sektorit Privat:** Rritje e produktivitetit si rezultat i përdorimit të teknologjive të reja, përmirësimi i cilësisë të produkteve bujqësore, rritje e eksporteve si dhe rritje e të ardhurave nga prodhimi, tregtimi dhe eksporti. Përdorimi i burimeve të energjisë së rinovueshme, si panelet diellore dhe energjia nga biomasa, kontribuojnë në një bujqësi më të qëndrueshme dhe kosto të ulët operative. Po kështu, është parashikuar mundësia e shitjes së energjisë elektrike kur femeri gjykon se e ka më shumë se sa i nevojitet. Po kështu, ulet nevoja për përdorimin e ujit për vaditje. Teknologjitë inovative mund të optimizojnë përdorimin e burimeve natyrore si: uji, plehrat kimike dhe pesticidet. Kjo redukton ndikimin negativ në mjedis dhe siguron një bujqësi më të qëndrueshme afatgjatë. Ndërkaq, rritja e investimeve nga subjektet private në sektorin bujqësor do të përkthehet në rritje të prodhimit bujqësor, investimet mund të financojnë teknologji të reja, praktika më të mira bujqësore, zgjerim të fermave, gjë që çon në rritje të sasisë dhe cilësisë së produkteve bujqësore. Rritja e eksporteve të produkteve të prodhuara, sidomos për akuakulturat, është një objektiv i rëndësishëm për subjektet që do të investojnë në këtë sektor.

- **Kosto të Sektorit Publik:** Nuk identifikohen kosto të reja të konsiderueshme për sektorin publik, pasi kompetencat do të ushtrohen nga strukturat ekzistuese. Por, qeveritë detyrohen të hartojnë politika që inkurajojnë adoptimin e teknologjive të reja nga fermerët. Gjithashtu, është e rëndësishme të sigurohet që politikat të jenë të përshtatshme për fermerët e vegjël dhe të mesëm, të cilët mund të kenë vështirësi në adoptimin e teknologjive të reja.

- **Përfitime të Sektorit Publik:** Përfitimet përfshijnë rritjen e të ardhurave nga taksat, si dhe përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë në plan afatgjatë. Inovacionet teknologjike kërkojnë një nivel të caktuar njohurish dhe aftësish nga stafi administrativ prandaj, programet e edukimit dhe trajnimeve janë të domosdoshme për të maksimizuar përfitimet nga këto teknologji dhe metoda të zbatimit sipas parashikimeve të projektligjit. Rritja e investimeve nga subjektet private në sektorin bujqësor ka pritshmëri të mëdha në rritje të prodhimit bujqësor. Investimet mund të financojnë teknologji të reja, praktika më të mira bujqësore, zgjerim të fermave. Rritja e eksporteve të produkteve të prodhuara, sidomos për akuakulturat, duke patur parasysh që prodhimi i BE-së përfaqëson 1% të prodhimit global dhe importon 60% të saj, nga subjektet që do të investojnë në këtë sektor. Ky opsion kërkon investime fillestare të konsiderueshme, por ndikimet afatgjata sociale, ekonomike dhe mjedisore justifikojnë kostot. Rritja e eksporteve dhe përmbushja e standardeve të BE-së mbi cilësinë e produkteve pritet të kenë një ndikim pozitiv për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe të vendit më gjerë, duke mbështetur kështu edhe objektivat kombëtare për integrim evropian dhe mirëqenie të shtuar dhe shoqërinë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar:

Nga analiza me shumë kritere, e kryer për të tre opsionet tregoi se **Opsioni 2**, hartimi i ndryshimeve të ligjit “Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” është vlerësuar më me shumë pikë duke e zgjedhur si opsionin e preferuar. Ky opsion është zgjedhur si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm.

Opsioni 2 (rregullator) ofron qasjen më të mirë për të mundësuar pasurimin e ligjit me mënyrat dhe teknologjitë e reja të cilat pritet të japin efekte shumë pozitive lidhur me cilësinë dhe pjellorinë e tokës në kushtet kur si rezultat i përdorimit intensiv dhe shpesh pa kritere të ekosistemeve natyrore. Ndryshimet e propozuara kanë pritshmëri të madhe lidhur me përmirësimin e situatës aktuale në fushën e tokave bujqësore dhe zhvillimin e bujqësisë. Zgjedhja e këtij opsioni si opsioni i preferuar do të bëjë të mundur rritjen ekonomike, garantimin e cilësisë së ushqimit dhe shëndetit të kafshëve në të njëjtën kohë përmirësimin e kushteve mjedisore.

Miratimi i këtyre ndryshimeve ligjore konsiderohet se ofron mënyrën më të mirë për të arritur objektivat. Ky opsion ofron qasjen më të mirë për thjeshtimin, qartësinë, koherencën dhe reduktimin e barrës administrative. Propozimet që bëhen kanë për qëllim adresimin e problematikave të evidentuara duke përditësuar dhe përcaktuar metoda dhe rregulla të reja, inovative dhe të përshtatshme në tokën bujqësore e cila ka rëndësi thelbësore për bujqësinë dhe zhvillimin e saj duke qenë në qendër të politikave të qeverisë së Shqipërisë.

Nga analiza me shumë kritere e kryer për të tre opsionet tregoi se Opsioni 2, propozimi i ndryshimeve ligjore është vlerësuar më me shumë pikë duke e zgjedhur nga ana jonë si

opsionin e preferuar. Ky opsioni është zgjedhur si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm duke ofruar qasjen më të mirë për të mundësuar pasurimin e ligjit me metodat dhe teknologjitë e reja të cilat pritet të japin efekte shumë pozitive lidhur me cilësinë dhe fertilitetin e tokës. Ndryshimet e propozuara kanë pritshmëri të madhe lidhur me përmirësimin e situatës aktuale në fushën e tokave bujqësore dhe zhvillimin e bujqësisë. Zgjedhja e këtij opsioni bën të mundur rritjen ekonomike, garantimin e cilësisë së ushqimit, shëndetit të kafshëve në të njëjtën kohë përmirësimin e kushteve mjedisore.

Ndryshimet ligjore kanë për qëllim shfrytëzimi me efektivitet të tokave bujqësore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përmes përfshirjes në procesin e dhënies me qira edhe të aktiviteteve që lidhen me metodat inovative në bujqësi si metoda agrifotovoltaike. Përdorimi i këtyre metodave të reja do të sjellë rritjen e investimeve dhe të prodhimit bujqësor duke shfrytëzuar dhe vënë në efikasitet tokat bujqësore me fertilitet të ulët.

Veçanërisht risi për bujqësinë shqiptare është metoda e zhvillimit të bimësisë përmes agrifotovoltaik e cila është metoda e kombinimit midis aktivitetit bujqësor dhe prodhimit të energjisë së rinovueshme, ku parësore është aktiviteti bujqësor. Kjo është metoda inovative që kombinon prodhimin e energjisë diellore me bujqësinë në të njëjtën sipërfaqe toke. Në këtë sistem panelet fotovoltaike vendosen mbi tokën bujqësore ose mbi serra duke lejuar bimët të rriten. Përdorimi i paneleve diellore në serra pritet të kenë ndikime pozitive në disa aspekte të rëndësishme siç janë: lejimi i dritës së diellit të kalojë pjesërisht, në varësi të nevojave të bimëve, mbrojtja e bimëve nga ndryshimet klimatike (rrezet e forta, breshëri etj.), prodhimi i energjisë elektrike e cila mund të përdoret për pompat e ujit, sistemet e ndriçimit ose të shitet në rrjetin elektrik. Nga zbatimi i metodës agrifotovoltaike arrihet përdorimi i dyfishtë i tokës duke ndihmuar fermerët të përfitojnë si nga prodhimi bujqësor ashtu edhe nga energjia e rinovueshme duke rritur të ardhurat sepse fermerët mund të shesin energjinë elektrike ose ta përdorin për serra dhe makineri. Nëpërmjet kësaj politike që propozohet, synohet të bëhen sa më të shfrytëzueshme tokat bujqësore të cilat janë në administrim të MBZHR-së, të cilat për shkaqe të ndryshme siç janë cilësitë jo të mira dhe kushteve jo të favorshme të terrenit, nuk kanë efektivitet dhe prodhimtari bujqësor të lartë.

Për të gjitha arsyet e renditura, Opsioni 2 është opsioni më i përshtatshëm i cili pritet të ketë ndikim pozitiv në përfitueshmërinë dhe rritjen ekonomike të sektorëve të përfshirë në zbatimin e këtij ligji.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lekë, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

KONSULTIMI

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar, ishin:

- konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike, REKNJP, nga data 6.2.2025 deri më datë 6.3.2025;
- komunikimi përmes postës elektronike.

Palët të cilët kanë shprehur interes dhe kanë paraqitur komente janë “Shehu & Partners Law Firm”, komunikim përmes postës elektronike:

Komentet janë:

1. Ndryshimet që kërkohen të bëhen janë të paqarta në kushtet kur ligji ka përcaktuar dhe lejuar ndërtimin e infrastrukturës dhe veprave ndihmëse për zhvillimin, prodhimin, tregtimin, shfrytëzimin, operimin, shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme fotovoltaike dhe eolike dhe ndërtimin e infrastrukturës për vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme në tokat bujqësore me bonitet 9 dhe 10, pra cilat do të jenë afatet e dhënies me qira për tokën-pasuri shtetërore, sipas sugjerimit, nuk ka nevojë për këtë ndryshim pasi vetë ligji parashikon se strukturat që duhet të instalohen për ushtrimin e aktivitetit të agrifotovoltaike lejohen të ndërtohen në toka bujqësore me bonitet 9 dhe 10. Mendojmë se pika 5, që kërkohet të shtohet në nenin 8 nëpërmjet këtij ligji, të përcaktojë qartë afatet e dhënies me qira të tokës pasuri shtetërore, duke pasur në vëmendje kohën që i duhet çdo investimi të lejuar nga ligji për prodhimin e energjisë në këto toka.

- Lidhur me këtë koment Ministria shprehet se ky koment nuk qëndron, pasi Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nuk jep toka bujqësore në administrim të saj për aktivitet fotovoltaike. Ligji për dhënien me qira të tokës bujqësore dhe VKM-në Nr. 373/2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” që përcakton procedurat e dhënies me qira të tokës bujqësore, e përcakton qartë që toka në administrim të MBZHR-së jepet për aktivitet bujqësor ose agrifotovoltaike dhe vetëm për këto aktivitete është përcaktuar një afat kontrate. Pra, nuk jepet për ushtrim vetëm të aktivitetit fotovoltaike. Kjo është dhe arsyeja pse është bërë ndryshimi tek ligji për mbrojtjen e tokës bujqësore që konsiston, në dhënien me qira vetëm të investitorëve strategjikë të tokave bujqësore në administrim të MBZHR-së me bonitet 9 dhe 10, për ushtrim vetëm të aktivitetit fotovoltaike. Sipërfaqet përkatëse të tokës që do t’u vihen në dispozicion investitorëve strategjikë pasi të kenë fituar statusin, transferohen në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike dhe administrohen në vijim nga MEKI, pra jo më nga MBZHR. Pra palë në kontrata të tilla nuk do të jetë MBZHR, por Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë

2. Sugjerim lidhur me riformulimin e nenit 15 të projektligjit. Neni 15 i ligjit është riformuluar duke sjellë tashmë një rregull të ri ku rezulton se është hequr fare dhënia me qira e tokës-pasuri shtetërore nga organet përkatëse, nëpërmjet ankandit. E para është

cënues parimi i sigurisë së normës juridike dhe jo vetëm; dhe pyetja është: “Çfarë do të ndodhë me tokat pronë shtetërore të cilat mund të vihen në dispozicion të investimeve të lejuara tashmë nga Ligji Nr. 9244, datë 16.6.2004 “Për mbrojtjen e tokave bujqësore”, që nuk janë pjesë e këtij fondi?

Për më tepër, kur në projektligj nuk gjejmë as një rregullim se çdo të bëhet me procedurat e ankandit të filluara tashmë nga institucionet përkatëse sipas akteve në fuqi apo me kontratat e lidhura tashmë për këtë qëllim.

Vazhdimi i këtyre kontratave duhet të sigurohet nëpërmjet parashikimeve ligjore të sakta në draftin e projektligjit. Përsa më sipër, të rishikohet ndërhyrja në nenin 15, duke mos hequr marrjen e tokës pasuri shtetërore me qira, nëpërmjet ankandit, e harmonizuar kjo me parashikimet dhe me ndryshimet e reja ligjore, në përputhje me ligjin organik të fushës suaj, që është Ligji Nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar.

- Lidhur me këtë koment Ministria sqaron se komentit pranohet, si dhe do të reflektohet në draft, duke bërë jo riformulim të nenit 15 por duke bërë shtesa. Pra, pas përcaktimeve të nenit 15 që janë në fuqi si më poshtë: “Dhënia me qira e tokës pasuri shtetërore nga organet përkatëse bëhet nëpërmjet ankandit. Rregullat e ankandit dhe kontrata tip e dhënies me qira të tokës përcaktohen nga Këshilli i Ministrave”, duke mos hequr këto dy paragrafë të nenit.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet në përputhje me dispozitat përcaktuese të këtij projektligji siç vijon:

- a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- b) Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- c) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- ç) Agjencia Kombëtare e Mjedisit-Kontrolli i Ndikimit Mjedisor të projekteve të reja;
- d) Komitetit i Investimeve Strategjike-vlerësimi dhe miratimi i investimeve strategjike në bujqësi dhe energji.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural** është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tokave bujqësore në administrim të MBZHR-së. Si autoriteti kompetent qendror, MBZHR koordinon punën e institucioneve të varësisë. Monitorimi kryhet nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në MBZHR dhe AREB-et si institucione të tyre të varësisë.

- **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, tokat bujqësore të kategorisë 9 dhe 10 të bonitetit, në administrim të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë lejohen të jepen për aktivitet fotovoltaiik vetëm për investitorët strategjikë sipas vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike. Sipërfaqet përkatëse të tokës transferohen në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike.

- **Agjencia Kombëtare e Mjedisit** – kontrolli, monitorimi i ndikimit mjedisor të projekteve të reja, ushtron funksione monitoruese në kuadër të ruajtjes mjedisore, kërkimin dhe dijen mjedisore, vlerësimi impaktit mjedisor dhe licensimi, inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

- **Komiteti i Investimeve Strategjike** - Komiteti i Investimeve Strategjike ka këto detyra:

- a) monitoron funksionimin e sistemit të “*dritares unike*” për shërbimet ndaj investitorit strategjik;
- b) monitoron performancën e ndikimit të investimeve strategjike e të ecurisë së tyre, si dhe miraton programet konkrete për mbështetjen dhe stimujt për investimet strategjike;
- c) miraton planin e veprimit për masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e një projekti investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit;
- ç) miraton projektet me statusin “*projekt me potencial strategjik*”.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatueshmërisë së opsionit të preferuar do të kryhet nga Drejtoria përgjegjëse monitorimin e kontratave pjesë e strukturë organizative të Ministrisë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si institucion përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave për tokat bujqësore në administrim të saj si dhe AREBET si institucione varësie të MBZHR më disa të drejta mbi tokat bujqësore.

Me qëllim monitorimin efikas dhe vlerësimin e zbatueshmërisë së opsionit të preferuar, MBZHR bashkëpunon edhe me bashkitë, këshillat e qarqeve, prefekturat dhe strukturat e tjera të ngarkuara nga ligji në fuqi.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës

Deri në vitin 2016, mbi 80% e të gjitha zonave në vendet e BE-së ishin vlerësuar si të prekura nga erozioni, në një shkallë që varionte nga mesatare deri në të rëndë, dhe që kryesisht përfshinin toka bujqësore dhe kullota natyrore. Përqindja e tokave bujqësore dhe kullotave natyrore që vlerësoheshin të ndikuara nga erozioni i tillë, nga uji, ra me 2.6 pikë përqindje në BE-së mes viteve 2000 deri në vitin 2016.

Aktualisht referuar të dhënave të marra nga INSTAT, rezulton se numri i të punësuarve në bujqësi ka ardhur në rritje sipas tabelës së mëposhtme:

Total të punësuar	1,265,582	1,243,345	1,248,749	1,298,380	1,327,042
Të punësuar në bujqësi, nr.	460,876	448,390	422,077	440,440	428,635
Të punësuar në bujqësi, %	36.4%	36.1%	33.8%	33.9%	32.3%

Ndërsa strukturat e tokës nga viti 2019 deri 2023 (në hektar) paraqiten¹:

Sipërfaqja	2019	2020	2021	2022	2023
Tokë gjithsej	2874.9	2875.0	2875.0	2875.0	2875.0
Tokë bujqësore	696.0	687.6	687.5	686.4	678.4
Livadhe dhe kullota	478.1	478.1	448.8	449.2	366.1
Pyje	1051.8	1051.8	1146.7	1146.7	969.9
Toka të tjera	649.0	657.5	592.0	592.7	860.6

Erozioni mund të përkufizohet si konsumimi i sipërfaqes së tokës nga forcat fizike të tilla si reshjet, uji i rrjedhshëm, era, akulli, ndryshimi i temperaturës, graviteti ose agjentë të tjerë natyrorë ose antropogjenë që gërryejnë, shpëputin dhe largojnë dheun ose materialin gjeologjik nga një pikë e tutje. sipërfaqja e tokës të depozitohet diku tjetër. Kur përdoret në kontekstin e presioneve në tokë, erozioni i referohet humbjes së përsheptuar të tokës si rezultat i aktivitetit antropogjen, mbi normat e pranuar të formimit natyror të tokës. Humbja e tokës çon në një rënie të përmbajtjes së lëndës organike dhe lëndëve ushqyese, në prishjen e strukturës së tokës, në një reduktim të ujit të depozituar të tokës në dispozicion, gjë që mund të çojë në një rrezik të shtuar të përmytjeve dhe rrëshqitjeve të dheut në zonat ngjitur. Cikli i lëndëve ushqyese dhe i karbonit mund të ndryshohet ndjeshëm nga mobilizimi dhe depozitimi i tokës, pasi toka e gërryer mund të humbasë 75% - 80% të përmbajtjes së saj të karbonit, me rrjedhim të çlirimit të karbonit në atmosferë. Erozioni i tokës ndikon fuqishëm në mjedis dhe ka kosto të larta ekonomike; për të zbutur këto efekte, kërkohen strategji të ruajtjes së tokës dhe ujit².

Ekonomia shqiptare ka përfituar prej stabilitetit makroekonomik dhe reformave ekonomike, të cilat kanë siguruar mundësi zhvillimi për sektorin privat dhe nxitjen e investimeve. Shqipëria është një vend me një nivel mesatar të ardhurash, me të ardhura vjetore për frymë në vlerën 484,000 lekë ose 3,457 euro dhe me rritje ekonomike të qëndrueshme. Rritja ekonomike në vitin 2013 në terma realë ishte 1.39% dhe 2.02 në vitin 2014. Më 2014-n, sektori bujqësor (bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi) zinte rreth 20% të GDP-së, ndërsa Vlera Bruto e Shtuar në sektorin bujqësor kapi një vlerë prej 280,036 milionë lekësh, duke kontribuar me 0.44 pikë përqindje në rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe duke shënuar një rritje prej 5.6% krahasuar me vitin 2013.

Burimi kryesor i rritjes ekonomike gjatë periudhës së tranzicionit në bujqësinë shqiptare lidhet me një sërë faktorësh (toka, puna dhe kapitali), që në tërësinë e tyre nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim domethënës. Stabiliteti makroekonomik dhe liberalizimi ekonomik çoi në

¹ Shënim: Në të dhënat e vitit 2023 nuk përfshihet sipërfaqja e fondit kullosor dhe fondit pyjor që ndodhet brenda zonave të mbrojtura (si rrjedhojë këto të dhëna janë objekt rishikimi). Burimi informacionit INSTAT.

² Treguesit janë vlerësime të parashikuara dhe jo vlera reale. Ato rrjedhin nga një version i përmirësuar i modelit të Ekuacionit Universal të Rishikuar të Humbjes së Tokës i zhvilluar për të vlerësuar erozionin e tokës nga uji në një shkallë rajonale. Struktura e modelit është përshtatur për të marrë parasysh planifikimin e ruajtjes, shkallën e erozionit të inventarit dhe vlerësimin e shpërndarjes së sedimentit në bazë të njohurive të pranuar shkencore dhe gjykimit teknik. Në këtë vlerësim, modeli bazë RUSLE është përshtatur përmes përmirësimit të cilësisë së faktorëve të hyrjes. Marrë nga faqja zyrtare e BE-së: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Agri-environmental_indicator_-_soil_erosion.

rishpërndarjen e burimeve nga sektorët më pak përfitues (drithërat) tek aktivitetet më me leverdi (pemëtaria, perimet dhe mbarështimi i blegtorisë), të cilat i mundësuan bujqësisë rritjen e mëtejshme me më pak investime.

Struktura e tokës bujqësore private dhe situata aktuale e fragmentimit të saj. Shpërndarja e tokës bujqësore gjatë reformës së tokës në fillim të viteve '90, krijoi një strukturë sipërfaqesh të vogla e të fragmentuara. Sipas Vjetarit Statistikor të MBZHR (2011), në Shqipëri figurojnë rreth 388,697 familje fermere, ku sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi të çdo familjeje fermere është rreth 1.26 ha të ndara në 4.7 parcela me një sipërfaqe mesatare për parcelë prej 0.27 ha. Referuar të dhënave të INSTAT-it, qershor 2014, në Shqipëri figurojnë rreth 352.315 familje fermere, ku sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi të çdo familje fermere është rreth 1.16 ha. Rreth 46% e fermave kanë një sipërfaqe nën 1 ha, ndërsa 86% e tyre nën 2 ha. Sipërfaqja totale e tokës bujqësore prej 696,000 ha përfshin 24% të të gjithë territorit të vendit. Nga kjo sipërfaqe, rreth 562,000 ha ose 80% është në pronësi private dhe 134,000 ha ose 20% është në pronësi publike (shtetërore). Megjithatë, për shkak të ndërtimeve informale, zgjerimit të zonave urbane dhe tjetërsimit për investime publike fond i tokës bujqësore është zvogëluar dhe është në proces puna për saktësimin dhe pasqyrimin e tyre në dokumentacionin kadastral.

Nga sipërfaqja prej rreth 134,000 ha tokë bujqësore në pronësi shtetërore, 109, 500 ha janë toka të pandara të ish-kooperativave bujqësore - objekt i Ligjit Nr. 7501, miratuar më 1991 - *tokë*, që është refuzuar nga familjet rurale për shkak të pjellorisë natyrale relativisht të ulët, distancës së largët nga qendrat e banuara, mungesës së infrastrukturës (rrugë, kanale ujitëse), pjerrësisë dhe vendndodhjes përgjithësisht në zonat kodrinore-malore. Nga sipërfaqja e tokave të pandara, e cila është në administrim të bashkive për t'u dhënë me qira, 23,368 ha ka kaluar në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (VKM-ja Nr. 770, datë 12.4.2014; Fletore Zyrtare Nr. 185, viti 2014). Në pronësi të shtetit përfshihen gjithashtu, edhe rreth 25,000 ha tokë bujqësore, që ka qenë në pronësi të ish-fermave shtetërore, e pandarë për shkak të tejkalimit të normës së sipërfaqes së tokës për frymë (aktualisht në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave), që shërben si tokë për qiradhënie dhe për institucionet shtetërore në kuadër të kryerjes së detyrave të tyre institucionale.

Nga të dhënat që disponohen, rezulton se përgjatë vitit 2023 sipërfaqja faktike e ujitur në funksion të përdorimit të tokave bujqësore, mbledhur këto nga bashkitë e qyteteve si: Berat, Poliçan, Kuçovë etj. është 189.734 ha. Ndërkaq, numri i fermave që përdorin plehra kimike deri në vitin 2013, ishte 342.083. Po sipas INSTAT, deri në vitin 2019 kishte vetëm 3 ferma të cilat kanë objekt të prodhimit produkte bujqësore organike.

Janë pikërisht ulja e përdorimit të plehrave kimikë, përdorimi i ujit për vadtje masivisht, varësia nga energjia elektrike, rritja e numrit të fermave për produkte bujqësore organike, ndër qëllimet kryesore që propozimet ligjore synojnë të arrihen përmes metodave moderne të kultivimit të bimëve.

Struktura e tokës së kultivuar dominohej nga bimët e arave, pemët frutore, ullinjtë, agrumet dhe vreshtat³.

Sipërfaqja gjithsej e njësisë ekonomike bujqësore (fermës) është tërësia e terrenit të përbërë nga shumë e sipërfaqes bujqësore të përdorur (SBP) dhe sipërfaqes së tokës tjetër. Sipërfaqja bujqësore e përdorur (SBP) përbëhet nga:

- o tokë e punueshme (arë);
- o tokë e zënë me kultura drufrutore;
- o kopshtet e shtëpive dhe;
- o kullota dhe livadhet.

Me tokë të punueshme kuptojmë tokën e pluguar ose e lëruar rregullisht, sipas një sistemi të qarkullimit bimor. Qarkullimi bimor është praktika e rritjes alternative të kulturave bimore njëvjeçare në një fushë specifike sipas një modeli ose renditje të planifikuar në vitet prodhuese pasuese. Normalisht, kulturat njëvjeçare ndryshojnë çdo vit, por ato mund të jenë edhe shumëvjeçare (jonxhë). Për të dalluar tokën e punueshme nga toka e zënë me kultura drufrutore ose kullota e livadhe përdoret një prag prej pesë vjetësh. Sipërfaqja e kultivuar me bimë arash, është sipërfaqja e mbjellë me bimë arash në vitin bujqësor të dhënë. Këtu bëhet fjalë për sipërfaqe me kultura kryesore (të para).

Këto kultura kryesore, normalisht kanë vlerë ekonomike më të lartë se kulturat e tjera dhe zënë tokën në pjesën më të madhe të vitit. Kulturat kryesore janë drithërat e bukës, kulturat e pranverës misri kokërr, patatja, fasulja, bimët industriale, foragjeret shumëvjeçare, etj.

Sipërfaqja e tokës tjetër, veç asaj të bujqësisë, përbëhet nga: sipërfaqja e zënë nga pyjet, sipërfaqja bujqësore e papërdorur dhe sipërfaqja jo bujqësore. Sipërfaqja e tokës bujqësore e kultivur është sipërfaqja totale e mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore specifike gjatë një viti të dhënë, nga e cila përjashtohet sipërfaqja e dëmtuar nga dëmtues natyror (përmbytjet, zjarre etj.).

Deri më tani, mbrojtja e tokës bujqësore është realizuar në bazë të një kuadri rregullator të përbërë nga aktet si më poshtë:

➤ **Ligje**

1. Ligji Nr. 10263, datë 8.4.2010 “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”;
2. Ligji Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar.

➤ **Vendime të Këshillit të Ministrave**

1. Vendim Nr. 656, datë 28.7.2010 “Për përcaktimin e detyrave, përgjegjësisë të Bordit të Qiradhënies procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore të pakultivuara dhe kontratës së qiradhënies së tyre”;

³ Vendim Nr. 700, datë 12.10.2016 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për konsolidimin e tokës në Shqipëri” fq. 1.

2. Vendim Nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”;
3. Vendim Nr. 410, datë 27.6.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorisë së resurseve të tokës”;
4. Vendim Nr. 45, datë 29.1.2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave”, i ndryshuar;
5. Vendim Nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, i ndryshuar;
6. Vendim Nr. 283, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e tipave rregullave kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokën bujqësore”, i ndryshuar;
7. Vendim Nr. 404, datë 19.6.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për marrjen e masave parandaluese për përhapjen e zjarreve në tokat bujqësore”;
8. Vendim Nr. 387, datë 12.6.2024 “Për kriteret për përdorimin e tokës bujqësore për kryerjen e aktivitetit agrifotovoltaik dhe eolik në tokat bujqësore, procedurat për monitorimin e ushtrimit të aktivitetit, përfshirë masat për shkeljen e kushteve të ushtrimit të aktivitetit dhe përcaktimin e tarifës”.

➤ **Akte të tjera nënligjore**

1. Udhëzim Nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”;
2. Udhëzim Nr. 10, datë 9.7.2020 “Për mënyrën e marrjes së mostrave për ndryshimin e kategorisë së resursit nga tokë e pafrytshme dhe tokë urbane truall, nëntokë bujqësore dhe kryerjen e analizave”;
3. Udhëzim Nr. 8, datë 27.4.2020 “Për një shtesë në Udhëzimin Nr. 5, datë 13.3.2017, “Për krijimin e informacionit mbi tokën bujqësore nga zbatimi i programit “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*
- *Përshkruani natyrën e problemit.*

Në Shqipëri tregu formal i tokës rurale (shitjet dhe qiradhënia) nuk është zhvilluar plotësisht. Që nga fillimi i procesit të privatizimit dhe deri në vitin 2007, më pak se 2% e familjeve rurale kanë shitur tokën në tregun formal dhe vetëm 3.6% kanë marrë me qira

tokën e tyre. Pavarësisht reformës së tokës së vitit 1991, e cila solli ndryshim radikal të zotërimit të tokës dhe të drejtës së pronësisë sot, shkalla e lartë e fragmentarizimit dhe krijimi i fermave të vogla, kanë çuar në uljen e prodhimit bujqësor, përdorimin e teknologjive joadequate, degradimin e tokës, si dhe impakte të tjera negative në sektorin bujqësor me ndikim të theksuar mbi shumicën e popullsisë rurale. Infrastruktura e varfër rurale dhe të ardhurat e ulëta janë një faktor kryesor që ka ndikuar në migracionin e popullsisë drejt zonave urbane dhe jashtë vendit⁴.

Tokat bujqësore, qoftë ato në pronësi shtetërore apo në përdorim privat, përballen me një sërë problematikash, përfshirë boshllëqe ligjore në procesin e ndarjes së tyre, mungesë qartësie mbi pronësinë, si dhe konflikte të shpeshta gjyqësore që lidhen me të drejtat e pronësisë. Një nga problematikat më të shpeshta në Shqipëri mbetet konsolidimi i tokës. Siç është përmendur edhe më parë, mungesa e dokumentacionit të pronësisë, pasiguria mbi statusin juridik të tokës bujqësore, të dhënat e pasakta kadastrale, rastet e mbivendosjeve si dhe zbatimi i dobët i strategjive për konsolidim, përbëjnë faktorë pengues për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë në vend, duke ndikuar negativisht edhe në krahasim me performancën e vendeve të rajonit.

Problematikat e identifikuara kanë natyrë rregullatore, kjo mbështetur në shumë shkaqe që prekin aspekte siç janë: problematika e pronësisë së tokës bujqësore, standardi ligjor i ruajtjes së tokës bujqësore, përdorimi apo ndryshimi i statusit “tokë bujqësore” në një status të ndryshëm juridik (truall etj.), infrastruktura e pazhvilluar etj. Në vijim po shtjellojmë çështje të rëndësishme parësore lidhur me objektin e çështjes në shqyrtim.

Problematikat në Sektorin e Bujqësisë dhe Tokave Bujqësore në Shqipëri:

Përshkrimi i problematikave:

- **Kuadri rregullator i vjetëruar dhe i fragmentuar:** Ligjet dhe aktet e tjera rregullatore ekzistuese janë shpesh të bazuara në politika të miratuara dekada më parë, kur struktura ekonomike dhe demografike e vendit ishte ndryshe. Ndërkaq Ligji Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” është përditësuar vetëm njëherë në vitin 2018, që nga viti 1998 kur ka hyrë në fuqi.
- **Paaftësia për të tërhequr investime të reja:** Mungesa e një kuadri modern ligjor dekurajon investitorët vendas dhe të huaj, duke mos ofruar garanci të mjaftueshme për të drejtat e qiramarrësve dhe afatgjatësinë e kontratave.
- **Mungesa e mekanizmave efektivë për zhvillimin bujqësor:** Kuadri aktual nuk ofron mjedis të përshtatshëm maksimalisht për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore moderne për dhënien me qira të tokave bujqësore. Mungesa e një politike të qartë krijon pasiguri për të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësve dhe qiradhënësve, duke ndikuar negativisht në menaxhimin e këtyre tokave.
- **Probleme me titujt e pronësisë dhe regjistrimin e tokës:** Shumë toka bujqësore shtetërore nuk kanë dokumentacion të rregullt pronësie ose janë objekt i mosmarrëveshjeve gjyqësore. Kjo situatë pengon procesin e qiradhënies nga shteti dhe krijon pasiguri për investitorët potencialë. Konkretisht referuar raporteve të Kontrollit

⁴ Vendim Nr. 700, datë 12.10.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Konsolidimin e Tokës në Shqipëri” fq.2.

të Lartë të Shtetit aktualisht gjithsej 3.136 ha e 6012 m² e tokës bujqësore është në administrim të MBZHR-së. Sipërfaqe e lirë e disponueshme në përgjegjësinë e MBZHR-së për t'u dhënë me qira është 15 897 ha e 3488 m² ose 83% e sipërfaqes gjithsej. Nga kjo sipërfaqe është dhënë me qira nga MBZHR, për periudhën 2013-2021, sipërfaqja prej 107.6105 ha. Sipërfaqja e lirë e disponueshme në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së për t'u dhënë me qira është 15896 ha e 5.334 m² duke konstatuar se gjendja juridike është e paregjistruar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës duke rritur rrishtet e tjetërsimit të pronave bujqësore nga palët e treta. Ministria lidhur me fondin e tokës bujqësore në administrim të saj vazhdimisht, përmes strukturave përkatëse, kërkon informacion mbi statusin aktual juridik nga institucionet kompetente.

- **Fragmentimi i tokës bujqësore:** Ndër vite, toka bujqësore është fragmentuar në parcela të vogla, duke e bërë më të vështirë menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të saj. Ky fragmentim ndikon negativisht në produktivitetin dhe atraktivitetin e tokës për investitorët.
- **Mungesa e infrastrukturës dhe investimeve në tokat e dhëna me qira:** Shumë prej tokave bujqësore shtetërore që jepen me qira kanë mungesë të infrastrukturës bazë, si sisteme ujitjeje dhe kullimi, gjë që e bën të vështirë shfrytëzimin e tyre të plotë dhe të efektshëm.

Një tjetër problematikë lidhet me mungesën e përdorimit të teknologjive bashkëkohore dhe mungesën e investimeve për përmirësimin e cilësisë së tokës bujqësore në tërësi. Kjo ka sjellë pasoja negative në gjithë zinxhirin bujqësor, duke ndikuar në uljen e sasisë dhe cilësisë së prodhimit, nivelin e të ardhurave dhe punësimit në sektor, rritjen ekonomike përmes tregtisë dhe eksporteve, si dhe në shëndetin e kafshëve, veçanërisht kur bëhet fjalë për tokat që shfrytëzohen si kullota. Në këtë kontekst, duke marrë në konsideratë rëndësinë strategjike të tokës bujqësore dhe nevojën për inovacion në sektorin bujqësor, parashikohen ndryshime ligjore që synojnë adresimin e këtyre problematikave.

Grupet e prekura nga këto problematika janë:

- Operatorët e bizneseve;
- Qeveria;
- Fermerët;
- Komuniteti dhe shoqëria civile;
- Punëmarrësit;
- Prodhuesit e produkteve bujqësore.

1. Kuadri rregullator i vjetëruar dhe i fragmentuar

- Problematika: Ligji nuk është përditësuar në mënyrë të vazhdueshme për të reflektuar përparimet shkencore dhe teknologjike në bujqësi.
- Pasojë: Ka një hendek midis zhvillimeve aktuale të sektorit dhe legjislacionit në fuqi.

- **Problematikë:** Aktualisht, metodat inovative që përdoren në bujqësinë e përparuar nuk janë të parashikuara në legjislacion konkretisht metoda agrifotovoltaike.
- **Pasojë:** Procedurat mbeten komplekse dhe kërkojnë ndërhyrje manuale, duke parashikuar shprehimisht metodat inovative dhe bonitetin ku do të lejohen përdorimi i tyre në tokën bujqësore me pronar shtet.
- **Problematika:** Ligji ekzistues nuk adreson në mënyrë efektive potencialin për të rritur konkurrueshmërinë e sektorit dhe për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin rural.
- **Pasojë:** Prodhimi bujqësor dhe zinxhiri i vlerës mbetet i kufizuar duke mos reflektuar kapacitetin e mundshëm.

Grupet e prekura nga ky problem:

Qeveria - mosrealizimi në plotësimin e kushteve të BE-së për ofrimin e një mjedisi ligjor i cili lejon zhvillimin sipas potencialit të investimeve bujqësore, strategjike, pamundësia për zbatimin e politikave dhe përfitimin e financimeve, forcimin e sektorit bujqësor, ekonomik, ekonominë e tregut dhe aftësitë konkurruese.

Fermerët- pengesa serioze për zhvillimin e veprimtarive bujqësore në potencial, paaftësi në rritjen ekonomike të tyre, prodhim më i dobët bujqësor, zhvillim i ulët i zonave rurale.

Operatorët e biznesit- në këtë sektor hasen me detyrimin për import më shumë se sa aftësinë për eksport si pasojë e prodhimit më të ulët, të ardhura më të vogla nga tregtia si pasojë e cilësisë më të dobët të produkteve dhe sasinë më të vogël.

Komuniteti-cenim i vlerave të zinxhirit ushqimor për shkak të cilësisë së dobët të produkteve bujqësore, zhvillim jo i mirë i zonave rurale, mundësi punësimi më të pakta.

2. Paaftësia për të tërhequr investime të reja:

- **Problematika:** Mjedis jo tërheqës dhe me pengesa për investitorët vendas dhe të huaj, duke mos ofruar garanci të mjaftueshme për të drejtat e qiramarrësve dhe afatgjatësinë e kontratave.
- **Pasojë:** Zhvillim i kufizuar, kushte ligjore që përbëjnë pengesë për tërheqjen e investimeve me ndikim negativ në zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural si tërësi.

Grupet e prekura nga ky problem:

Qeveria - mungesë financimi, zhvillim i kufizuar i bujqësisë, dështim në arritjen e qëllimeve politike për rritjen e aftësive konkurruese në tregun europian dhe atë të rajonit, pamundësi e rritjes së aftësive ekonomike të vendit, dështim në plotësimin e parakushteve të BE-së.

Fermerët - Mungesë financimi duke i bërë ata edhe më të varur nga subvencionet, të ardhura të pakta, pamundësi e zhvillimit të aktiviteteve bujqësore duke përdorur metoda inovative, dështim në rritjen e prodhimit dhe cilësisë, duke u bërë të varur nga importet për të plotësuar kërkesat e tregut.

3. Mungesa e mekanizmave efektivë për zhvillimin bujqësor:

Problematika:

- **Problematika:** Kuadri aktual nuk ofron mjedis të përshtatshëm maksimalisht për ushtrimin e veprimtarisë bujqësore moderne për dhënien me qira të tokave bujqësore.

- Pasojë: Mungesa e një politike të qartë krijon pasiguri për të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësve dhe qiradhënësve, duke ndikuar negativisht në menaxhimin e këtyre tokave.

Grupet e prekura nga ky problem:

Qeveria - investime të pamjaftueshme edhe pse janë bërë përpjekje për të përmirësuar kuadrin ligjor, investimet mbeten të ulëta në krahasim me nevojat e sektorit. Dështim në përmirësimin e qëllimeve për rritjen e prodhimit dhe të ardhurave në zonat rurale, duke rritur varfërinë dhe pabarazinë.

Fermerët - dështojnë të rrisin prodhimin dhe cilësinë, duke u bërë të varur nga importet për të plotësuar kërkesat e tregut.

Industria - përpunuese merr produkte me cilësi të ulët, duke ndikuar negativisht në të ardhurat dhe konkurrencën në tregun global.

4. Probleme me titujt e pronësisë dhe regjistrimin e tokës:

- Problematika: Shumë toka bujqësore shtetërore nuk kanë dokumentacion të rregullt pronësie ose janë objekt i mosmarrëveshjeve gjyqësore.
- Pasojë: Kjo situatë pengon procesin e qiradhënies nga shteti dhe krijon pasiguri për investitorët potencialë.

Grupet e prekura nga ky problem:

Qeveria- pasiguria dhe ndryshimi i statusit juridik të tokave bujqësore pengon seriozisht qeverinë që të shfrytëzojë tokat bujqësore me pronar shtet. Pasiguria e statusit juridik sjell pasiguri të investitorët e huaj dhe të vendit, ul mundësinë e investimeve afatgjata serioze në këtë sektor dhe sjell mungesë financimi.

Fermerët- hasin në pasiguri të mëdha lidhur me investimin që kryejnë në këto toka duke sjellë kërkesa të ulëta për dhënien me qira të tokave bujqësore nga shteti.

5. Fragmentimi i tokës bujqësore:

- Problematika: Ndër vite, toka bujqësore është fragmentuar në parcela të vogla, duke bërë më të vështirë menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të saj.
- Pasoja: Ky fragmentim ndikon negativisht në produktivitetin dhe atraktivitetin e tokës për investitorët.

Grupet e prekura nga ky problem:

Qeveria- pamundësi për përdorim eficient në të gjithë potencialin për tokat bujqësore me pronar shtet, efekte negative në punësimin në këtë sektor, pamundësi për eksport të produkteve bujqësore dhe rritjen e nevojës për import, nivele të ulëta të ardhurash në këtë sektor.

Fermerët- shumë fermerë sot zotërojnë parcela të vogla, që e bëjnë të vështirë të rrisin shkallën e ekonomisë. Kjo situatë kontribuon në uljen e rendimenteve dhe efektivitetit në përdorimin e burimeve natyrore. Shumica e fermerëve nuk kanë burime të mjaftueshme për të investuar në rritjen e sipërfaqeve të fermave, duke bërë të vështirë për ta të konkurrojnë në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

6. Mungesa e infrastrukturës dhe investimeve në tokat e dhëna me qira:

- Problematika: Shumë prej tokave bujqësore shtetërore që jepen me qira kanë mungesë të infrastrukturës bazë, si sisteme ujitjeje dhe kullimi.
- Pasoja: Pengesa serioze dhe vështirësim të shfrytëzimit të tokave bujqësore në mënyrë të plotë dhe të efektshëm nga shteti.

Grupet e prekura nga ky problem:

Qeveria - efektet negative prekin punësimin dhe ulin të ardhurat nga qiradhënia e tokës bujqësore, eksportet në nivele të pakënaqshme të produkteve bujqësore, mosplotësimi i standardeve të BE-së për sektorin bujqësor, joeficënca e tokave me ferilitet të ulët.

Komuniteti - cenohet cilësia e produkteve bujqësore, moszhvillim i zonave rurale sipas potencialit, më pak mundësi për punësim në sektorin e bujqësisë.

Fermerët- përballen me ulje të rendimentit dhe mundësi të kufizuar për zhvillim, duke i bërë ata të varur nga subvencionet dhe ndihmat e jashtme. Vështirësi në transportimin e produkteve, duke e bërë më të vështirë shitjen në tregje dhe zvogëluar fitimet.

Në konkluzion, problemi mund të trajtohet vetëm përmes ndryshimit të politikave duke hartuar një kornizë solide të vetme ligjore.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*

Nëpërmjet kësaj nisme synohet adresimi i problematikave të evidentuara duke përditësuar dhe përcaktuar metoda dhe rregulla të reja, inovative dhe të përshtatshme lidhur me tokën bujqësore e cila ka rëndësi thelbësore për bujqësinë dhe zhvillimin e saj duke qenë në qendër të politikave të Qeverisë së Shqipërisë.

Qëllimi kryesor i kësaj nisme është ofrimi i shfrytëzimit dhe përdorimit maksimal të tokave bujqësore, rritja e mundësisë për qiradhënie, rritje të prodhimit bujqësor përmes metodave inovative, ulja e shpenzimeve energjitike dhe përdorimi i teknologjive inovative, të cilat përdoren sot në bujqësinë europiane, si rrjedhojë ka pritshmëri për rritje të madhe ekonomike për fermerin, shoqërinë, qeverinë etj. Shqipëria ka një mundësi të artë për të zhvilluar bujqësinë organike, në harmoni me objektivin e Strategjisë së BE-së “*Nga ferma në tavolinë*”, për të arritur që bujqësia organike të zërë 25% e tokës bujqësore deri në vitin 2030, po ashtu me shtyllën IV, të Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor: “Promovimi i bujqësisë miqësore me mjedisin dhe organike dhe reduktimi i produkteve kimike sintetike të përdorura në prodhimin e ushqimit: pesticidet, ilaçet veterinare dhe plehurat”. Përveç kësaj, kërkesa në rritje e tregut për produkte organike është një potencial dhe mundësi reale që duhet të shfrytëzohet. Përafrimi gradual me standardet e BE-së dhe promovimi i praktikave të mira për mirëmbajtjen e burimeve natyrore, si: ajri, toka dhe uji (shih, gjithashtu, objektivin ndërsektorial).

Aktualisht, praktikat e mira bujqësore promovohen sistematikisht në Shqipëri. Zbatimi i tyre do të realizohet përmes hartimit dhe vënies në zbatim të Kushteve të Mira Bujqësore dhe Mjedisore (KMBM) të thjeshtuara, përveç standardeve minimale ligjore ekzistuese. Këto kushte do të jenë të detyrueshme për të gjithë përfituesit e mbështetjes së të ardhurave dhe pagesave kompensuese. Kuadri i standardeve të KMBM-ve synon të kontribuojë në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në mbrojtjen e ujit, tokës dhe

biodiversitetit. Një rishikim i thellë i kuadrit ligjor është i domosdoshëm për të modernizuar dhe përmirësuar këtë sistem, duke e përshtatur atë me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe nevojat aktuale të tregut shqiptar të bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka ndërmarrë disa nisma në kuadër të shfrytëzimit sa më të favorshëm të tokave bujqësore, të cilat janë strukturuar sipas disa aspekteve kryesore, si më poshtë:: konsolidimi i tokës bujqësore (miratuar Strategjia e VKM-së Nr. 700/2016), bashkëpunimi me institucionet e tjera në vend, kompetente për identifikimin e statusit të tokës bujqësore, parashikimet ligjore të cilat specifikojnë trajtimin, qiradhënien, mbrojtjen, përcaktimin specifik të tokave bujqësore në administrim të saj etj.

Kjo nismë është në përputhje me dokumentet e nivelit të lartë të Qeverisë si:

1. Strategjia së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027;
2. Programi Qeverisë 2021-2025.
3. Vendimi Nr. 700, datë 12.10.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Konsolidimin e Tokës në Shqipëri”.

- *Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027 (SBZHRP 2021-2027)* është dokumenti politik i qeverisë shqiptare, i cili synon të përcaktojë objektivat, të krijojë kuadrin e nevojshëm institucional, të politikave dhe të instrumenteve që mundësojnë arritjen e këtyre objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë, zonave rurale dhe peshkimit, si dhe përmbushjen e angazhimeve, në kuadër të procesit të përafrimit të Shqipërisë në BE. SBZHRP trajton në mënyrë të hollësishme çështjet e tokës bujqësore në pronësi të shtetit si një nga hallkat vitale të sektorit të bujqësisë në Shqipëri. Në këtë këndvështrim trajtohen edhe rritja e madhësisë së fermës, konsolidimi i tokës dhe orientimi ndaj tregut i fermerëve të vegjël, konsolidimi i tokës etj.

- *Programi i Qeverisë së Shqipërisë 2021-2025* është mbështetur në 5 shtylla kryesore ndër të cilat është përfshirë bujqësia⁵ ku Qeveria synon të modernizojë sektorët e ekonomisë prodhuese, turizmit, ekonomisë digjitale, bujqësisë, konektivitetit dhe energjisë. Programi ka për qëllim vijimin në zbatimin e politikave për të rritur cilësinë e jetës në fshat dhe për të diversifikuar hapësirat dhe mundësitë për aktivitetet ekonomike, zbutja e diferencës së standardeve të jetesës mes qytetit e fshatit duke nxitur rritjen e ndërveprimeve ekonomike e sociale përmes vijimit të investimeve në ujësjellës-kanalizime, energji elektrike, shërbime shëndetësore e arsimore, infrastrukturë rrugore dhe në përmirësimin e teknologjisë së njohurive prodhuese, si dhe legjislacion që i përgjigjet realitetit inovativ të sotëm. Në programin e qeverisjes qeveria ka vendosur synim arritjen e një ekonomie të fortë bazuar në modernizim, produktivitet dhe konkurrueshmëri. Qeveria ka për qëllim forcimin e rrugës e modernizimit të ekonomisë prodhuese, turizmit, ekonomisë digjitale, bujqësisë, konektivitetit dhe energjisë duke investuar në zhvillimin teknologjik do të nxitet një ekonomi e fortë prodhuese, duke siguruar që kompanitë e suksesshme dhe ndërmarrjet e reja në vend të krijojnë një vlerë të shtuar në zinxhirin e prodhimit. Ndërmarrjet e manufakturës nuk do të jenë më të kufizuara në regjimin e përpunimit aktiv për “brandet”

⁵ Programi i Qeverisë 2021-2025 fq. 3.

ndërkombëtare, duke kaluar në nivel tjetër, në ciklin e plotë të prodhimit duke promovuar markën “*Made in Albania*”, me të cilën do të konkurrojmë globalisht.

- *Strategjia Kombëtare për Konsolidimin e Tokës* në Shqipëri ka synim dhe objektiv konsolidimin e tokës përmes forcimit të zbatimit të reformës për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, uljen e shkallës së fragmentizimit dhe krijimit të fermave të vogla duke shmangur kështu uljen e prodhimit bujqësor, degradimin e tokës bujqësore si dhe impaktin negativ në sektorin bujqësor me ndikim të theksuar mbi shumicën e popullsisë rurale. SKKT trajton edhe çështjen e tregut të tokës, konkretisht: Në Shqipëri ende nuk është zhvilluar plotësisht një treg formal i tokës rurale (shitjet dhe qiradhënia). Që nga fillimi i privatizimit dhe deri në vitin 2007, më pak se 2% e familjeve rurale ka shitur tokën në tregun formal dhe vetëm 3.6% ka marrë me qira tokën e tyre. Sidoqoftë, është e dukshme që në tokat në zonat rurale tregu informal është mbizotërues. Është vlerësuar se 6% e fermave familjare kanë dhënë me qira tokat e tyre dhe madhësia mesatare e fermës po rritet ngadalë, gjë që tregon se pronarët vazhdojnë të kryejnë transaksione të tokës me njëri-tjetrin⁶.

Ndërhyrja e qeverisë vjen si rezultat i synimit për të investuar dhe promovuar përdorimin e metodës inovative të agrifotovoltaikës në bujqësi, që përfshin prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e tokës bujqësore. Qeveria parashikon, para së gjithash, investimin në përmirësimin e cilësisë së tokës bujqësore në tërësi, duke pasur në fokus të gjithë zinxhirin bujqësor – nga sasia dhe cilësia e prodhimit, te niveli i të ardhurave dhe punësimit në sektor, deri te rritja ekonomike e nxitur nga zgjerimi i tregtisë dhe eksporteve. "Në këtë këndvështrim, duke marrë parasysh rëndësinë strategjike të tokës bujqësore dhe nevojën për integrimin e inovacioneve në prodhimin bujqësor, propozohen ndryshime në ligjin aktual me qëllim arritjen e objektivave të paracaktuara. Një rishikim i thellë i kuadrit ligjor është i domosdoshëm për të modernizuar dhe përmirësuar këtë sistem, duke e përshtatur atë me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe nevojat aktuale të tregut shqiptar të bujqësisë.

Problematikat që janë identifikuar janë të natyrës rregullatore dhe ndërhyrja e qeverisë duhet të ndërmerret në funksion të arritjes së disa qëllimeve të shumëfishta të cilat lidhen me shfrytëzimin me efektivitet, mbrojtjen dhe kujdesin e vazhdueshëm lidhur me fertilitetin e tokës bujqësore përmes përcaktimeve sa më të përshtatshme, si dhe konkretizimin e aktiviteteve që lidhen me teknologjitë inovative që do të përdoren në bujqësi si metodat e kultivimit agrifotovoltaik. Përdorimi i këtyre teknologjive të reja do të sjellë rritjen e investimeve dhe të prodhimit bujqësor duke shfrytëzuar dhe vënë në efikasitet toka bujqësore me pjellori të ulët, përgjysmimin e kostove për fermerin si rrjedhojë e pavarësisë së ushtrimit të aktiviteteve bujqësore nga përdorimi i energjisë elektrike, mundësinë e shitjes së energjisë elektrike nga fermeri etj.

Kjo nismë parashikon disa risi, të cilat janë trajtuar në mënyrë të detajuar në vijim të këtij dokumenti, por në mënyrë të përmblendhur, mund të përmenden disa prej tyre: përdorimi i metodës agrifotovoltaike në bujqësi;

⁶ Vendim Nr. 700, datë 12.10.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Konsolidimin e Tokës në Shqipëri” fq. 3.

- prodhimi i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e tokës;
- rregullimi i afatit për instalimin e infrastrukturës së prodhimit të energjisë;
- parashikime për kontratën tip;
- lloji i bonitetit të tokave bujqësore ku do të lejohen përdorimi i këtyre parashikimeve.

Metoda “Agrifotovoltaike” është metoda e kombinimit midis aktivitetit bujqësor dhe prodhimit të energjisë së rinovueshme, ku parësor është aktiviteti bujqësor, etj. Kjo është metoda inovative që kombinon prodhimin e energjisë diellore me bujqësinë në të njëjtën sipërfaqe toke. Në këtë sistem panelet fotovoltaike vendosen mbi tokën bujqësore ose mbi serra duke lejuar bimët të rriten. Panelet diellore instalohen në atë mënyrë që:

- lejojnë dritën e diellit të kalojë pjesërisht, në varësi të nevojave të bimëve;
- mbrojnë bimët nga rrezet e forta të diellit, erërat e forta dhe breshëri;
- prodhojnë energji elektrike e cila mund të përdoret për pompat e ujit, sistemet e ndriçimit ose të shitet në rrjetin elektrik.

Avantazhet e metodës “Agrifotovoltaike” janë:

- përdorim i dyfishtë i tokës duke ndihmuar fermerët të përfitojnë si nga prodhimi bujqësor ashtu edhe nga energjia e rinovueshme;
- mbron bimët nga ndryshimet klimatike duke reduktuar avullimin e ujit dhe i mbron nga temperaturat ekstreme;
- kursen ujë sepse panelet krijojnë hije dhe zvogëlojnë nevojën për ujitje;
- rrit të ardhurat sepse fermerët mund të shesin energjinë elektrike ose ta përdorin për serra dhe makineri.

Disa disavantazhe mund të jenë:

- kosto fillestare e lartë për instalimin e paneleve;
- nevojiten studime për vendosjen e duhur të paneleve në mënyrë efikase;
- disa bimë mund të kenë nevojë për më shumë dritë dhe nuk përshtaten mirë.

Pavarësisht këtyre, kjo metodë po përparon dhe po bëhet gjithmonë e më popullore për një bujqësi të qëndrueshme dhe të pavarur nga përdorimi i energjisë elektrike. Megjithatë arritjet në sektorin e fruta/perimeve Shqipëria ende nuk i plotëson nevojat e veta të tregut dhe të konsumit. Kjo vjen si rezultat i një sërë faktorësh siç janë:

- humbjet në prodhim;
- sipërfaqen e vogël të fermës;
- mungesën e fuqisë punëtore (migrimi dhe emigrimi) si dhe nivelin e ulët të teknologjisë së prodhimit në disa zona dhe fermerë të caktuar;
- çmimet e larta të inputeve bujqësore;
- mungesës së unitetit midis prodhuesve (kooperimi), etj.

Suksesi i prodhimit dhe i marketingut bashkëkohor të prodhimeve bujqësore varet nga shkalla e zbatimit të arritjeve të shkencës dhe teknologjive bashkëkohore, kualifikimi i specialistëve të fushës, mekanizmat e përdorur në proceset e punës dhe marketingut, si edhe shpejtësia dhe saktësia e informacionit. Faktorët e sipërmendur, bëjnë të domosdoshëm thellimin e punës shkencore në fushën e bujqësisë, krahas politikave mbështetëse të

Qeverisë për realizimin e prodhimit të integruar për përballimin me sukses të sfidave të tregut në përgjithësi dhe globalizimit të tij në veçanti.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka si objektiv shfrytëzimin me efektivitet të tokave bujqësore, mbrojtjen dhe kujdesin e vazhdueshëm lidhur me fertilitetin e tokës bujqësore përmes përcaktimeve sa më të përshtatshme si dhe konkretizimin e aktiviteteve që lidhen me teknologjitë inovative që do të përdoren në bujqësi si metoda e kultivimit agrifotovoltaik. Përdorimi i këtyre teknologjive të reja do të sjellë rritjen e investimeve dhe të prodhimit bujqësor duke shfrytëzuar dhe vënë në efikasitet toka bujqësore me pjellori të ulët.

Në vijim po rendisim të gjithë punën ekzistuese që është realizuar deri më tani:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas fushës së saj të përgjegjësisë, harton dhe zbaton politikat e konsolidimit dhe mirëadministrimit të tokës bujqësore dhe dhënien me qira të tokave bujqësore në administrim të saj, si autoritet qiradhënës, mbrojtjen e tokës bujqësore nga proceset natyrore dhe faktorët e tjerë që mund ta dëmtojnë atë. Ministria identifikon nevojat për përmirësimin në fushën e saj të përgjegjësisë, si dhe metodat për plotësimin e këtyre nevojave. Në një proces të tillë, Ministria vendos mbi natyrën e plotësimit të këtyre nevojave, nëse ajo paraqitet rregullatore ose jo dhe më pas vijon me propozimet për miratime apo ndryshime ligjore sipas objektit të çështjes.

Ministria ka ndërmarrë disa nisma në kuadër të shfrytëzimit sa më të favorshëm të tokave bujqësore, kjo e ndarë në disa aspekte siç janë: konsolidimi i tokës bujqësore (miratuar Startegjia e VKM-së Nr. 700/2016), bashkëpunimi me institucionet e tjera në vend, kompetente për identifikimin e statusit të tokës bujqësore, parashikimet ligjore të cilat specifikojnë trajtimin, qiradhënien, mbrojtjen, përcaktimin specifik të tokave bujqësore në administrim të saj etj.

Në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë aktualisht ka një drejtori të posaçme, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme ku Sektori për Bashkëfinancimin dhe Partneritetin e Kontratave dhe Sektori i Monitorimit të Kontratave të Bashkëfinancimit të cilët kanë në përkrahje të tyre të detyrave ndër të tjera, evidentimin e parcelave në varësi të MBZHR-së, menaxhimin e të dhënave për këto parcela, monitorimin e kontratave që MBZHR lidh me palët e treta për dhënien me qira të tokës bujqësore në administrim të saj. Sektorët që kanë objekt tokën bujqësore në Ministri bashkëpunojnë me instanca të tjera shtetërore të qeverisë qendrore dhe asaj lokale për identifikimin, cilësimin e statusit juridik, politikat, monitorimin e tokës bujqësore etj. Veç kësaj, MBZHR bashkëpunon dhe vepron përmes institucioneve të saj të varësisë siç janë agjencitë rajonale të ekstensionist bujqësor, lidhur me qiradhëniet, monitorimin në terren, bashkëpunimin me organet e qeverisë lokale, raportimin e problematikave, bashkëpunimin me policinë etj.

MBZHR, për periudhën 2013 -2023 ka lidhur gjithsej 54 kontrata qiradhënie tokë bujqësore, nga të cilat 45 kontrata janë aktive dhe vlerësohen sipas parashikimeve kontraktuale, 3 (tre) kontrata janë zgjidhur, 2 (dy) kontrata janë në proces gjyqësor, për 2 (dy) kontrata është kërkuar zgjidhja vullnetare nga subjekti dhe për 2 (dy) kontrata ka përfunduar procesi gjyqësor.

Për vitin 2022-2023, nuk është realizuar asnjë procedurë për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit, në administrim të MBZHR-së, edhe pse ka rreth 30 kërkesa nga subjekte ose persona të ndyshëm, por të pashqyrtuara nga sektori përgjegjës.

Në total, janë dhënë me qira 3 136 hektarë e 6 012 metra katrorë tokë bujqësore, që përfaqësojnë 17% të sipërfaqes në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Aktualisht, sipërfaqja e lirë e disponueshme për dhënie me qira, që ndodhet në përgjegjësi dhe administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është 15 897 hektarë e 3 488 metra katrorë, që përfaqëson rreth 83% të sipërfaqes totale. Aktiviteti shtrihet në të gjithë territorin e Shqipërisë, në të gjitha zonat ku ka kontrata të lidhura për tokat bujqësore të dhëna me qira.

Objekti i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë si më poshtë:

1. Harmonizimi i kuadrit rregullator për qiradhënien e tokave bujqësore me legjislacionin për investimet strategjike dhe rritja e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor shqiptar, brenda vitit 2026;
2. Lehtësimi i procedurave për investitorët strategjikë në sektorin e bujqësisë;
3. Përfshirja e teknologjive të përparuara (agrifotovoltaike) si veprimtari të lejuara në tokat bujqësore shtetërore;
4. Krijimi i një klime më të favorshme për investimet në bujqësi dhe rritja e produktivitetit bujqësor;
5. Përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve për zhvillimin e teknologjive të reja bujqësore në tokat shtetërore, brenda vitit 2027;
6. Rritja e përdorimit të teknologjive të gjelbra në bujqësi dhe përmirësimi i produktivitetit;
7. Rritja e transparencës dhe efikasitetit në qiradhënien e tokës bujqësore shtetërore;
8. Rritja e dhënies me qira e tokave bujqësore brenda afatit 5-vjeçar, me 5% nga momenti i miratimit të nismës⁷.
9. Rritja me 20% e nivelit të investimeve si pasojë e përdorimit të metodave inovatore nga subjektet private në sektorin bujqësor dhe të peshkimit, brenda një afati prej 5 vitesh nga miratimi i nismës.

Në përgjithësi, projektakti ka për qëllim plotësimin e kuadrit ligjor për lejimin e ushtrimit të aktivitetit bujqësor përmes teknologjive inovative si: aeroponia, akuaponia dhe hidroponia për t'u zhvilluar në tokë bujqësore në mënyrë që të sigurohet shfrytëzimi i atyre

⁷ Lidhur me përllogaritjet që janë parashikuar në rubrikën “Objekti i Politikës” vlen të përmendet se parashikimet janë indikator makro dhe performanca e sektorit bujqësor llogaritet nga INSTAT, sidomos kur kemi të bëjmë me përllogaritje financiare. Për të bërë një vlerësim të tillë do kërkohej një analizë *ex ante* dhe *post ante* i impaktit të metodave inovative, nëpërmjet studimeve sektoriale. Për këtë arsye vlerat mbeten në kuadrin e parashikimeve me përafrim.

tokave bujqësore duke krijuar të ardhura nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja për rritjen e konkurrencës dhe efektivitetin e prodhimit.\

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar të tre opsionet:

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma për ndryshime legislative, nënkupton mosdhënien e një zgjidhjeje të problematikave të evidentuara, mosadresimin e tyre dhe mospasurimin me risi të ligjit në fuqi. Kjo qasje nënkupton që nuk do të ketë ndërhyrje në legjislacionin aktual dhe se problemet e evidentuara do të vazhdojnë të mbeten pa zgjidhje. Qëndrimi në gjendjen aktuale do të thotë që ligji ekzistues do të mbetet i pandryshuar dhe që do të injorohen problematikat e vazhdueshme në sektorin e bujqësisë. Avantazhet e këtij opsion janë disa:

- Ruajtja e status quo-së ofron një ambient të qëndrueshëm për fermerët dhe investitorët, duke evituar pasigurinë që mund të vijë nga ndryshime të papritura ligjore.
- Nuk ka kosto: Shmangia e shpenzimeve për rishikime ligjore dhe procese të reja miratimi.

Disavantazhet janë:

- Problemet e evidentuara do të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në sektorin e bujqësisë, siç janë fragmentarizimi i tokës dhe degradimi i mjedisit.
- Do të pengohet përmirësimi dhe adoptimi i praktikave të reja dhe teknologjive, duke e bërë sektorin të pazhvilluar dhe joefikas.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri dhe shfuqizimi i ligjit aktual “Ligji Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” nuk jep zgjidhjen e duhur lidhur me problematikat të cilat janë evidentuar. Ky opsion nuk është i përshtatshëm, nuk trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh në kohë duke mos dhënë rezultatet e duhura. Ky opsion parashikon miratimin e një ligji të ri dhe shfuqizimin e ligjit aktual në fuqi. Megjithatë, ky opsion nuk ofron zgjidhje efektive për problematikat e evidentuara dhe nuk trajton nevojat aktuale të sektorit.

Avantazhet janë:

- Miratimi i një ligji të ri mund të sjellë një frymë të re dhe të nxisë besimin te fermerët dhe investitorët.
- Një ligj i ri mund të ketë procedura më të thjeshta dhe më efektive për menaxhimin e tokës dhe mbrojtjen e saj.

Disavantazhet janë:

- Pasiguria: Shfuqizimi i ligjit ekzistues mund të krijojë një periudhë pasigurie për fermerët, derisa të implementohet ligji i ri;
- Pamundësia për zgjidhjen e problematikave në një kohë të shpejtë;

- Hartimi i ligjeve të reja zakonisht kërkon një analizë të thellë dhe konsultime me palët e interesuara, si fermerët, ekspertët e sektorit dhe organizatat civile. Kjo mund të vonojë procesin, duke e bërë atë të ngadalshëm;
- Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri paraqet kosto të larta në drejtim të burimeve njerëzore dhe kohës së kërkuar prej tyre në këtë proces.

Opsioni 2 - (rregullator): Ky opsion parashikon ndryshime dhe përditësimin e ligjit aktual në fuqi”. Rishikimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 8318/1998 synon të sjellë një modernizim të kuadrit ligjor për qiradhënien e tokave bujqësore shtetërore, duke përfshirë teknologji të reja dhe praktika të qëndrueshme bujqësore. Në vend që të hartohet një ligj krejtësisht i ri (siç parashikohet në Opsionin 1) apo të lihet kuadri aktual pa ndryshime (Opsioni 0 - status quo), ky opsion përfaqëson një zhvillim të balancuar, të qëndrueshëm dhe të arritshëm.

Avantazhet e Opsionit të Preferuar janë:

1. Përshtatje më e shpejtë dhe më e lehtë e legjislacionit ekzistues:
 - Në vend që të hartohet një ligj krejtësisht i ri, rishikimi dhe ndryshimet në ligjin ekzistues lejojnë përshtatjen më të shpejtë dhe më të thjeshtë të legjislacionit.
 - Kjo shmang vonesat që mund të vijnë nga diskutime të gjata parlamentare apo debate të gjera mbi një ligj të ri.
2. Monitorim dhe zbatim më i thjeshtë:
 - Një ligj i përmirësuar, por ende brenda kornizës ekzistuese, është më lehtë i monitorueshëm nga institucionet përgjegjëse, pasi nuk kërkon një ristrukturim të plotë të administratës dhe të mekanizmave ekzistues.
 - Kjo do të thotë më pak kosto administrative dhe operacionale për shtetin dhe institucionet e përfshira.
3. Siguri ligjore dhe stabilitet për investitorët:
 - Bizneset dhe fermerët do të kenë siguri më të madhe ligjore për kontratat e qirasë, pasi kuadri ligjor mbetet i njëjtë, por i përmirësuar.
 - Nëse miratohet një ligj krejtësisht i ri, mund të krijohen pasiguri për investimet ekzistuese ose të reja.
 - Menaxhimi më i mirë i ujit dhe tokës, duke parandaluar degradimin e mjedisit.
4. Harmonizimi me politikat evropiane dhe të investimeve strategjike:
 - Shqipëria aspiron të harmonizojë politikat bujqësore me BE. Përmirësimi i ligjit do të sjellë risitë për shfrytëzimin e tokës bujqësore në përputhje me risitë evropiane.
 - Lehtëson procesin për investitorët strategjikë, të cilët aktualisht përballen me pengesa ligjore për zhvillimin e teknologjive inovative në tokat me qira shtetërore.
5. Rritja e prodhimit bujqësor dhe siguria ushqimore:
 - Me rritjen e mundësive për investime dhe zbatimin e metodave të reja të kultivimit, rritet numri i fermave prodhuese dhe shtohet prodhimi organik.
 - Kjo sjell cilësi më të mirë të zinxhirit ushqimor dhe një ndikim pozitiv në shëndetin e kafshëve dhe njerëzve.

6. Ndryshimet e propozuara nuk prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit aktual dhe për këtë arsye, në kuadër të teknikës legjislativë ndryshimi i ligjit aktual vlerësohet si më optimal.
7. Ndryshimet në ligj do të kenë kosto më të ulëta krahasuar me hartimin e një ligji të ri.

Disavantazhet e Opsionit të Preferuar:

1. Kosto më e lartë për zbatim.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të ishte forcimi i zbatimit të ligjit ekzistues në fuqi dhe rritja e llogaridhënies për strukturat kompetente ekzistuese. Trajnimi i stafit, forcimi i kërkesës së llogarisë, monitorimi më i shpeshtë i terrenit etj. Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, trajnimeve për stafin zbatues dhe rritjen e mbikëqyrjes së institucioneve dhe operatorëve të biznesit në këto sektorë.

Avantazhet e këtij opsioni janë:

1. Forcimi i masave për zbatimin e ligjit aktual e bën atë më të lehtë për t'u zbatuar dhe më të lehtë për t'u monitoruar nga institucionet përgjegjëse.
2. Garantimi i standardeve më të larta për mbrojtjen e tokës bujqësore, cilësinë e tokës bujqësore rrjedhimisht garantimin e një cilësie më të lartë të zinxhirit ushqimor dhe një shëndet më i mirë i kafshëve sipas parimit “Ushqim më i mirë, kafshë më të shëndetshme” por edhe në shëndetin e vet njeriut. Kjo mund të arrihet përmes forcimit të rregulloreve në fuqi pa imponimin rregullator të ri.

Disavantazhet e këtij opsioni:

1. Ndryshimet e konsideruara nëpërmjet këtij opsioni janë të pamundura të zhvillohen në tokat bujqësore në administrim të MBZHR-së, pasi ligji aktual nuk e lejon atë.
2. Mosarritja e qëllimit për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore në tokat bujqësore që jepen me qira nga shteti, me anë të metodës fotovoltaike, e cila është inovative, efektive dhe me shumë premisa pozitive në bujqësi dhe ekonomi, duke qenë se këto metoda mund të lejohen vetëm nëpërmjet ndryshimeve rregullore.

Pavarësisht sfidave, Opsioni 2 përfaqëson zgjidhjen më të plotë dhe të realizueshme në një afat më të shkurtër, pa kosto të konsiderueshme dhe me ndikim afatgjatë për adresimin e çështjeve të zhvillimit bujqësor. Ai ofron një bazë solide për të adresuar problematikat ekzistuese, për të harmonizuar politikat kombëtare me standardet evropiane dhe për të ndërtuar një sistem më efikas dhe të qëndrueshëm në fushën e politikës për tokat bujqësore në administrim të MBZHR-së.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*

- *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*

Ndryshimet e propozuara në Ligjin Nr. 8318, datë 1.4.1998, sjellin një zhvendosje të rëndësishme në qasjen ndaj administrimit të tokave bujqësore, duke integruar teknologji të reja, modele të qëndrueshme dhe mekanizma që stimulojnë investimet strategjike. Ky kuadër i përmirësuar synon të adresojë sfidat aktuale në bujqësi dhe energjinë e rinovueshme, duke balancuar nevojën për zhvillim ekonomik me mbrojtjen e mjedisit dhe interesin e komuniteteve të përfshira.

Grupet që preken janë:

- *Operatorët e bizneseve;*
 - *Qeveria;*
 - *Fermerët;*
 - *Shoqëria civile;*
 - *Punëmarrësit;*
 - *Prodhuesit e produkteve bujqësore.*
- o *Operatorët e bizneseve* - preken nga ky ligj pasi ligji parasheh normim të ri, rregulla dhe masa të reja për t'u plotësuar nga ana e operatorëve, kosto ekonomike që duhet të operohen prej tyre etj.
- o *Qeveria* - rrit punësimin, plotëson kushtet lidhur me grup-kapitullin bujqësi, për të cilin u hapën negociatat, merr përsipër të drejta dhe detyrime që burojnë nga ky ligj etj.
- o *Fermerët* - do të duhet të zbatojnë investime fillestare si rrjedhojë do të duhet të zbatojnë kushte të caktuara që përmbajnë kosto për ta por që me zbatimin e kësaj metode përgjysmojnë kostot për shkak të pavarësisë nga përdorimi i energjisë elektrike, prodhimin e energjisë elektrike vet dhe mundësinë e shitjes së saj etj.
- o *Shoqëria civile* - intensifikimi, zgjerimi dhe modernizimi i bujqësisë përforcon ofertën ekonomike dhe sociale në ato zona, duke sjellë një jetesë më të mirë për banorët ruralë, duke u ofruar të rinjve një mundësi më tepër punësimi dhe një ofertë ekonomike tërheqëse, dhe kështu edhe produkte më të mira dhe siguri më të lartë ushqimore etj.
- o *Prodhuesit e produkteve bujqësore* –shtim i lidhur me prodhimin, cilësinë më të lartë dhe paisje me teknologji inovative prodhuese më të përshtatshme, sipas kushteve të ligjit, që i përshtaten kërkesave të tregut të brendshëm por edhe atij europian e që përmban edhe kosto.
- o *Punëmarrësit* - më shumë mundësi punësimi si pasojë e hapjes së tregëtisë e eksportit, me shumë mundësi punësimi për profesionistët veterinerë lidhur me sigurinë e shëndetit të kafshëve, teknologët në fushën e industrisë përpunuese/prodhuese etj.

Disa nga grupet e prekura kanë përfitime të drejtpërdrejta si vijon:

Ndikimet sociale, ekonomike dhe mjedisore të hartimit të projektligjit të ri:

1. Ndikimet Sociale:

a. Operatorët e Bizneseve:

- Forcimi i tregut të brendshëm përmes rritjes së standardeve në cilësinë e produkteve.
- Më shumë mundësi për partneritete dhe bashkëpunime ndërkombëtare, veçanërisht me tregun evropian.
- Përfitime të reja për punonjësit nga rritja e kërkesës për produkte cilësore, duke përmirësuar kushtet e punës dhe zhvillimin profesional të stafit.

b. Qeveria:

- Nxitja e punësimit në bujqësi për profesionistë si agronomë, ekonlogë, hortikulturistë, fitoekologë dhe specialistë të tjerë të bujqësisë siç mund të jenë pedologët, edafologët, inxhinjerë të bujqësisë, mikrobiologët për tokën bujqësore rolin e saj dhe pjellorinë e saj etj.
- Rritjen e eksporteve, standarte më të larta të prodhimit organik, përmirësimi i imazhit të vendit në tregun evropian përmes përfaqësimit sipas standardeve të BE-së.
- Rritjen e investimeve, subvencionimeve e si rrjedhojë përfitimi i një force pune më të kualifikuar përmes programeve të trajnimeve.
- Rritja e kapaciteteve teknike dhe profesionale përmes investimeve në teknologji të reja.
- Krijimi i mundësive të reja punësimi në sektorin e bujqësisë së avancuar dhe energjisë së rinovueshme.

c. Fermerët:

- Rritje e standardve të jetesës për komunitetet rurale përmes rritjes së të ardhurave dhe garantimit të sigurisë ushqimore.
- Sigurime të larta shëndetësore për fermerët dhe familjet e tyre si rezultat i praktikave më të sigurta dhe më të kontrolluara të prodhimit.

ç. Punëmarrësit:

- Krijimi i vendeve të reja të punës, veçanërisht në zonat rurale, duke nxitur popullimin dhe zhvillimin e këtyre zonave.
- Mundësi për zhvillim profesional përmes programeve trajnuese në sektorët e përpunimit dhe bujqësisë.

d. Komuniteti dhe shoqëria civile:

- Përfitime nga rritja e sigurisë ushqimore dhe cilësisë së produkteve me origjinë shtazore.
- Përmirësimi i jetesës në zonat rurale përmes modernizimit të sektorit bujqësor dhe hapjes së eksportit.

2. Ndikimet Ekonomike:**a. Operatorët e Bizneseve:**

- Kosto fillestare për të përmbushur normat dhe rregullat e reja ligjore, por investimet do të përkthehen në përfitime afatgjata si kursime të dukshme në përdorimin e ujit për vaditje apo pavarësinë nga elektriciteti, rritja e eksportit dhe fitimeve.

- Përfaqësimi me standarte në tregun bujqësor europian me vendet e tjera të BE-së do të rrisë mundësitë për zhvillimin e ekonomisë vendase dhe rritjen e të ardhurave, investime më të mëdha në këtë fushë marrë në tërësi, aftësi për përthithje subvencionimesh, tregëtim i produkteve bujqësore më të sigurt në treg etj.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe teknologjive të avancuara si aeroponia, akuaponia dhe hidroponia mund të ulë kostot operationale dhe të rrisë prodhimin.
- Investimet në prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme do të sigurojnë të ardhura shtesë dhe diversifikim të aktiviteteve.
- Krijimi i mundësive të reja për sipërmarrësit në sektorin e bujqësisë dhe energjisë së rinovueshme.

b. Qeveria:

- Rritje të ardhurash nga doganat dhe tatimet si rezultat i rritjes së eksportit dhe tregtisë.
- Sigurimi i subvencioneve dhe granteve nga institucionet europiane për përmbushjen e standardeve të reja.
- Rritje e të ardhurave nga sigurimet shoqërore shëndetësore si rrjedhojë e rritjes së punësimit.
- Rritje e nivelit ekonomik të vendit si pasojë, e rritjes së nivelit të investimeve të brendshme dhe të huaja.
- Rritje e mirëqënies publike.
- Rritja e të ardhurave nga qiratë afatgjata dhe investimet strategjike.

c. Fermerët:

- Rritje e produktivitetit dhe fitimit si rezultat i standardeve të reja të biosigurisë dhe cilësisë.
- Mundësi për të aplikuar për subvencione dhe dëmshpërblime nga qeveria në rast sëmundjesh ose fatkeqësish natyrore.
- Rritje e të ardhurave për shkak të rritjes së tregëtisë bazuar në parimin produkt i sigurtë-cilësi, rritje e mirëqënies.

3. Ndikimet Mjedisore:

- Rritja e masave mbrojtëse për tokat bujqësore duke shmangur degradimin e tyre.
- Nxitja e praktikave të qëndrueshme për menaxhimin e burimeve natyrore.
- Reduktimi i ndotjes nga praktikat tradicionale të bujqësisë duke ulur përdorimin e plehrave kimike dhe ujit.
- Përmirësimi i cilësisë së tokës përmes praktikave të qëndrueshme;
- Kontributi në zvogëlimin e konsumit të energjisë konvencionale përmes përdorimit të energjisë diellore.

a. Operatorët e Bizneseve dhe fermerët:

- Rritja e standardeve të biosigurisë do të reduktojë ndotjen nga mbetjet bujqësore të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe të kafshëve, përdorimi i teknologjive të propozuara ka ndikim pozitiv në uljen e elementeve që ndikojnë në ndryshimet klimatike dhe ngrohjen globale.

- Investimet në infrastrukturën e fermave dhe serrave do të përmirësojë menaxhimin e burimeve natyrore.

b. Komuniteti:

- Përmirësimi i biodiversiteti, zhvillimi i jetesës në zonat rurale përmes praktikave më të qëndrueshme të prodhimit bujqësor.
- Rritja e transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrje.
- Produkte bujqësore më të sigurta, më shumë produkte organike, siguri ushqimore më e lartë në tërësi.
- Rritje e të ardhurave për shkak të hapjes së mundësisë për investime në bujqësi, më shumë mundësi për punësim, kërkesë më e lartë për profesionistë në fushën e bujqësisë.
- Përmirësimi i biodiversiteti në zonat rurale përmes praktikave më të qëndrueshme të prodhimit.

c. Qeveria:

- Përmes përmirësimit të kushteve në fermat bujqësore do të kontribuohet në ruajtjen e ekosistemeve dhe të balancës mjedisore.
- Rritje e mundësisë për punësit.
- Rritje e të ardhurave nga vjeljet e taksave doganore, sigurimet shoqërore, rritja e eksportit, përmbushje e standarteve europiane me fuqi konkurruese në tregun europian etj.

Nga analiza e mësipërme, duke vlerësuar si kostot ashtu edhe përfitimet, rezulton se të gjitha investimet dhe shpenzimet që lidhen me administrimin dhe dhënien me qira të tokave bujqësore nga shteti përfaqësojnë kosto që, në një perspektivë afatgjatë, përkthehen në përfitime konkrete si për aktorët e përfshirë, ashtu edhe për shoqërinë në tërësi. Këto ndërhyrje janë gjithashtu në përputhje me politikat e Qeverisë për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. *Kosto të drejtëpërdrejta në sektorin publik:* Momentalisht nuk identifikohen kosto në sektorin publik pasi kompetencat e parashikuara me këtë ligj do të ushtrohen nga strukturat ekzistuese të MBZHR-së dhe institucioneve të saj të varësisë.

Analiza sasiore e kostove është e pamundur të realizohet për arsye të mëposhtme, bazuar në informacionin e dhënë:

Të dhënat nga sektori privat janë të domosdoshme për të kuptuar kostot aktuale të operimit dhe ndikimet financiare të masave të propozuara. Në mungesë të këtyre të dhënave, është e pamundur të llogariten saktësisht kostot dhe përfitimet. Gjithashtu, ka mungesë të kriterëve të qarta. Pa informacion mbi kriteret specifike që operatorët privatë ndjekin, është e vështirë të përcaktohen elementet që ndikonjnë në kosto, si për shembull: infrastruktura, personeli, materialet apo teknologjia. Vlerësimi i ndikimit ekonomik kërkon të dhëna mbi të ardhurat që gjenerohen nga sektori në fjalë. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pamundur krahasimin mes kostove dhe të ardhurave për të matur përfitimet neto. Kjo analizë varet edhe nga kompleksiteti i këtij sektori. Disa sektorë kanë variabilitet të lartë në funksion të

operatorëve dhe veprimtarive të ndryshme. Mungesa e një baze të dhënash për këto variacione ndërlikon më tej analizën.

Përfitime të drejtpërdrejta në sektorin publik: Qeveria përfiton rritjen e tregut të punës me krijimin e më shumë vende pune në sektorin privat por prespektiva për punësimin e më shumë profesionistëve në sektorin publik është gjithashtu e lartë, pasi me zhvillimin e një ekonomie të re rritet kërkesa për profesionistë. Pritshmëritë shtrihen edhe më shumë të ardhura si pasojë e vjeljes së taksave, pagesave fiskale, të ardhura nga autoritet doganore, paisjen me makineri dhe paisje bujqësore të standarteve europiane etj. Në plan afatgjatë, fleksibiliteti i një kuadri të bazuar në rezultate do të imponojë uljen e ngarkesës së punës për administratën në fushën e bujqësisë por edhe në industrinë e lidhura me to. Me hapjen e grupkapitujve, dhe atë të bujqësisë, përmes miratimit të ndryshimeve ligjore që propozohen jo vetëm plotësohet kuadri ligjor sipas standarteve të BE-së në të njëjtën kohë synohet fillimisht të arrihet një impakt pozitiv në ekonominë e brendshme të vendit duke u krijuar vende të reja pune dhe hapjen e eksportit të kafshëve të gjalla dhe produkteve e prodhimeve bujqësore nga Shqipëria në vendet e BE-së.

Përfitimi i investimeve dhe rritja e interesit nga investitorë të rinj në vëndin tonë për shkak të përshtatjes së kuadrit ligjor kombëtar me acquis të BE-së, rritja e eksporteve të prodhimeve bujqësore në tregjet e vendeve të BE-së ka impakt pozitiv si në sektorin privat ashtu edhe atë publik gjithashtu në rritjen e mirqënies së shoqërisë.

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin privat: identifikohen kosto në sektorin privat me miratimin e këtij projektakti, por është e pamundur të plotësohet momentalisht nga ana jonë pasi në kushtet aktuale është i pamundur evidentimi i konstove apo të ardhurave që bashkëshoqërojnë biznesin në këtë veprimtari, pasi kemi mungesë të dhënash nga operatorët në sektorin privat lidhur me kushtet e punës dhe kriteret.

Përfitimet ekonomike për sektorin privat: Për operatorët e bizneseve, fermerët, përpunuesit/prodhuesit përfitimet janë – rritja e eksportit për produktet/prodhimet në vendet e BE-së, forcimin e tregut të brendshëm, rritjen e tregëtisë, shtimin e operatorëve të biznesit që do merren me tregëtinë, rritje e të ardhurave, investime më të mëdha në këtë fushë marrë në tërësi, produkte bujqësore shtazore më të sigurta në treg, rritje e standardeve dhe të të punësuarve etj.

Ndikimi social i drejtpërdrejtë: Rritja e punësimit si dhe rritja e prodhimit bujqësor në fshat, rritje e numrit të serrave, rritje e numrit të serrave organike etj. Në këtë aspekt pritshmëritë e rritjes së eksportit të produkteve nga Shqipëria në vendet e BE-së janë të larta. Rritja e cilësisë së jetesës në zonat rurale, rritja e aktivitetit ekonomik dhe social në fshat, popullimi i zonave rurale dhe krijimi i kushteve optimale për rikthimin e emigrantëve duke krijuar një mjedis të volitshëm ekonomik.

Ndikim jo të drejtpërdrejtë: nëpërmjet këtij ligji parashikohet të aplikohen çmime më të arsyeshme për konsumatorin, si dhe produkte/prodhime bujqësore më të kontrolluara dhe me cilësi më të lartë. Rritja e të ardhurave dhe ushqimit për familjet bujqësore, do të ketë ndikim edhe në standardin e jetesës, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, përmes produkteve ushqimore me çmime më të ulëta etj.

Ndikimi në mjedis: Projektligji synon që të rrisë interesin e fermerëve për të siguruar makineri me metova inovative gjatë prodhime bujqësore, sigurimin e kushteve më të mira të serrave, prodhime bujqësore më të shëndetshme konkurruese në tregun e brendshëm e më gjerë në mënyrë që të zhvillojnë një bujqësi më intensive, të standardizuar, të shëndetshme ku veç të tjerave ruahet e biodiversitetit dhe cilësia e tokës bujqësore.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimintuaj.*

Opsioni 2 (rregullator) ofron qasjen më të mirë për të mundësuar pasurimin e ligjit me mënyrat dhe teknologjitë e reja/inovatore, të cilat pritet të japin efekte shumë pozitive lidhur me cilësinë dhe pjellorinë e tokës në kushtet kur si rezultat i përdorimit intensiv dhe shpesh pa kriteret e ekosistemeve natyrore. Ndryshimet e propozuara kanë pritshmëri të madhe lidhur me përmirësimin e situatës aktuale në fushën e tokave bujqësore dhe zhvillimin e bujqësisë. Zgjedhja e këtij opsioni si opsioni i preferuar do të bëjë të mundur rritjen ekonomike, garantimin e cilësisë së ushqimit dhe shëndetit të kafshëve në të njëjtën kohë përmirësimin e kushteve mjedisore.

Opsioni konsiderohet se ofron mënyrën më të mirë për të arritur objektivat. Ky opsion ofron qasjen më të mirë për thjeshtimin, qartësinë, koherencën dhe reduktimin e barrës administrative. Ai adreson nevojën për funksionimin më të mirë të statusit shëndetësor të kafshëve dhe parashikon përdorimin e mjeteve moderne për prodhimin bujqësor dhe shfrytëzimin në mënyra përmes metodave inovative të bujqësisë dhe rritjen e efikasitetit të tokave bujqësore që jepen më qira nga shteti. Nga analiza me shumë kriteret e kryer për të tre opsionet tregoi se Opsioni 2, propozimi i ndryshimeve ligjore është vlerësuar më me shumë pikë duke e zgjedhur nga ana jonë si opsionin e preferuar. Ky opsion është zgjedhur si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm duke ofruar qasjen më të mirë për të mundësuar pasurimin e ligjit me metodat dhe teknologjitë e reja të cilat pritet të japin efekte shumë pozitive lidhur me cilësinë dhe fertilitetin e tokës. Ndryshimet e propozuara kanë pritshmëri të madhe lidhur me përmirësimin e situatës aktuale në fushën e tokave bujqësore dhe zhvillimin e bujqësisë. Zgjedhja e këtij opsioni bën të mundur rritjen ekonomike, garantimin e cilësisë së ushqimit, shëndetit të kafshëve në të njëjtën kohë përmirësimin e kushteve mjedisore.

Ndryshimet ligjore kanë për qëllim shfrytëzimin me efektivitet të tokave bujqësore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përmes përfshirjes në procesin e dhënies me qira edhe të aktivitetëve që lidhen me metodat inovative në bujqësi si metoda agrifotovoltaike. Përdorimi i këtyre metodave të reja do të sjellë rritjen e investimeve dhe të prodhimit bujqësor duke shfrytëzuar dhe vënë në efikasitet tokat bujqësore me fertilitet të ulët.

Veçanërisht risi për bujqësinë shqiptare është metoda e zhvillimit të bimësisë përmes metodës “agrifotovoltaike” që është metoda e kombinimit midis aktivitetit bujqësor dhe prodhimit të energjisë së rinovueshme, ku parësore është aktiviteti bujqësor. Kjo është

metoda inovative që kombinon prodhimin e energjisë diellore me bujqësinë në të njëjtën sipërfaqe toke. Në këtë sistem panelet fotovoltaike vendosen mbi tokën bujqësore ose mbi serra duke lejuar bimët të rriten. Përdorimi i paneleve diellore në serra pritet të kenë ndikime pozitive në disa aspekte të rëndësishme siç janë: lejimi i dritës së diellit të kalojë pjesërisht, në varësi të nevojave të bimëve, mbrojtja e bimët nga ndryshimet klimatike (rrezet e forta, breshëri etj), prodhimi i enenergjisë elektrike e cila mund të përdoret për pompat e ujit, sistemet e ndriçimit ose të shitet në rrjetin elektrik. Avantazhet të tjera që do të përftohen vijnë nga zbatimi i metodës agrifotovoltaike është përdorimi i dyfishtë i tokës duke ndihmuar fermerët të përfitojnë si nga prodhimi bujqësor ashtu edhe nga energjia e rinovueshme duke rritur të ardhurat sepse fermerët mund të shesin energjinë elektrike ose ta përdorin për serra dhe makineri.

Nëpërmjet kësaj politike që propozohet synohet të bëhen sa më të shfrytëzueshme tokat bujqësore të cilat janë në administrim të MBZHR-së, të cilat për shkaqe të ndryshme siç janë cilësitë jo të mira dhe kushteve jo të favorshme të terrenit, nuk kanë efektivitet dhe prodhimtari bujqësor të lartë. Qëllimi është krijimi i të ardhurave nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja duke rritur konkurrencën dhe efektivitetin e prodhimit bujqësor.

Shfrytëzimi me efektivitet i tokave bujqësore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural synohet të arrihet përmes përfshirjes në procesin e dhënies me qira edhe të aktiviteve që lidhen me teknologjitë inovative në bujqësi. Përdorimi i metodës agrifotovoltaik, do të sjellë rritjen e investimeve dhe të prodhimit bujqësor, duke shfrytëzuar dhe vënë në efikasitet tokat bujqësore me pjellori të ulët.

Metoda “agrifotovoltaike” është metoda e kombinimit të aktivitetit bujqësor dhe prodhimit të energjisë së rinovueshme, ku parësor është aktiviteti bujqësor etj. Kjo metodë inovative kombinon prodhimin e energjisë diellore me bujqësinë në të njëjtën sipërfaqe toke. Në këtë sistem panelet fotovoltaike vendosen mbi tokën bujqësore ose mbi serra duke lejuar bimët të rriten.

Përdorimi i paneleve diellore në serra pritet të kenë ndikime pozitive në disa aspekte të rëndësishme siç janë: lejimi i dritës së diellit të kalojë pjesërisht, në varësi të nevojave të bimëve, mbrojtja e bimët nga ndryshimet klimatike (rrezet e forta, breshëri etj), prodhimi i enenergjisë elektrike e cila mund të përdoret për pompat e ujit, sistemet e ndriçimit ose të shitet në rrjetin elektrik. Avantazhet të tjera që do të përftohen vijnë nga zbatimi i metodës agrifotovoltaike është përdorimi i dyfishtë i tokës duke ndihmuar fermerët të përfitojnë si nga prodhimi bujqësor ashtu edhe nga energjia e rinovueshme duke rritur të ardhurat sepse fermerët mund të shesin energjinë elektrike ose ta përdorin për serra dhe makineri.

Për të gjitha arsyet e renditura, Opsioni 2 konsiderohet opsioni më i përshtatshëm i cili pritet të ketë ndikim pozitiv në përfitueshmërinë dhe rritjen ekonomike të sektorëve të përfshirë në zbatimin e këtij ligji.

Nga analiza me shumë kritere e kryer për të tre opsionet rezulton se **Opsioni 2**, kryerja e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të

livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” është vlerësuar me më shumë pikë, duke e zgjedhur si option të preferuar.

Për të vlerësuar optionet dhe për të bërë të mundur një krahasim më të saktë ndërmjet tyre është kryer analiza me shumë kriterë dhe janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Opsioni 0 – status quo-ja; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma legislative, nënkupton vazhdimin e problemeve duke mos adresuar problematikat e evidentuara.

Opsioni 1 - (rregullator): Miratimi i një ligji të ri për tokat bujqësore që jepen me qira në administrim të shtetit/MBZHR-së.

Opsioni 2 - (rregullator): Rishikimi i Ligjit Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky option do të ishte forcimi i zbatimit të ligjit egzistues në fuqi dhe rritja e llogaridhënies për strukturat kompetente egzistuese duke mos ndërmarrë nisma për ndryshimin dhe përditësimin e tij.

Vendosja e peshës së kriterëve sipas rëndësisë relative

1. Efektiviteti në përmirësimin **në një kohë të shkurtër të procesit të qiradhënies** së tokës bujqësore-5;
2. Efektiviteti në stabilitetin dhe rritjen afatgjatë të sektorit bujqësor-5;
3. Efektiviteti në sigurimin e një menaxhimi të drejtë dhe shmangien e abuzimeve-3;
4. Efektiviteti në krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e kushteve për punëmarrësit-4;
5. Efektiviteti në lehtësimin e prodhimit dhe eksportimit të produkteve vendase-3;
6. Kosto-efektiviteti-5.

Për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e optionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5. Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo option për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson optionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës:Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2		Opsioni 3	
		Pikë	Vlera (= Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
1. Efektiviteti në përmirësimin e në një kohë të shkurtër të procesit të qiradhënies së tokës bujqësore;	5	0	0	4	20	5	25	1	5

2. Efektiviteti në stabilitetin dhe rritjen afatgjatë të sektorit bujqësor;	5	0	0	5	25	5	25	0	0
3. Efektiviteti në sigurimin e një menaxhimi të drejtë dhe shmangien e abuzimeve;	3	0	0	3	9	3	9	1	3
4. Efektiviteti në krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e kushteve për punëmarrësit;	3	0	0	3	9	3	9	0	0
5. Efektiviteti në lehtësimin e prodhimit dhe eksportimit të produkteve vendase;	2	0	0	2	4	2	4	1	2
6. Kosto-efektiviteti.	5	1	5	2	15	5	25	2	10
Pikët totale për secilin opcion			5		82		97		20

Analiza me shumë kritere tregon se Opsioni 2 (ndryshimi i Ligji Nr. 8318, datë 1.4.1998, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” është vlerësuar më me shumë pikë dhe e kemi zgjedhur atë si opcionin tonë të preferuar.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Zbatimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet në përputhje me dispozitat përcaktuese të këtij projektligji. Autoritetet përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e tokave bujqësore janë Drejtoria përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe autoritetet përgjegjëse siç vijon:

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit – Kontrolli i ndikimit mjedisor të projekteve të reja;
4. Komiteti i Investimeve Strategjike – Vlerësimi dhe miratimi i investimeve strategjike në bujqësi dhe energji.

- *Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*, është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tokave bujqësore në administrim të MBZHR-së. Si autoriteti kompetent qendror MBZHR koordinon punën e institucioneve të varësisë. MBZHR-ja do të mbetet autoriteti drejtues. Konkretisht detyrat e institucionit janë:

- a) Koordinon zbatimin dhe monitorimin e strategjisë së konsolidimit të tokës;
- b) Harton dhe përshtat programin kombëtar të konsolidimit të tokës;
- c) Financon, mbikëqyr dhe garanton zbatimin normal të projekteve të konsolidimit të tokës;
- ç) Përzgjedh dhe kontraktton entet për zbatimin e projektit;
- d) Siguron mbështetjen metodologjike për zbatimin e projekteve të konsolidimit të tokës;
- dh) Përzgjedh fshatrat për pjesëmarrjen në program bazuar në aplikimet e pranuar;
- e) Lehtëson paraqitjen e planit të riparcelizimit/rishpërndarjes të tokës për miratimin e tij nga ana e KKT-së, si dhe regjistrimin e mëvonshëm nga ana e ZVRPP-së;
- ë) Identifikon nevojat për trajnim së bashku me hartimin dhe zbatimin e programeve për ngritjen e kapaciteteve;
- f) Vendosi marrëdhënie bashkëpunimi me ministrinë e ndryshme dhe me agjencitë partnere;
- g) Përgatit raportet vjetore mbi zbatimin e strategjisë.

- *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*, tokat bujqësore të kategorisë 9 dhe 10 të Bonitetit, në administrim të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë lejohen të jepen për aktivitet fotovoltaiik vetëm për investitorët strategjikë sipas vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike. Sipërfaqet përkatëse të tokës transferohen në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike.

- *Agjencia Kombëtare e Mjedisit* – Kontrolli i ndikimit mjedisor të projekteve të reja, ushtron funksione monitoruese në kuadër të ruajtjes mjedisore, kërkimin dhe dijen mjedisore, vlerësimi impaktit mjedisor dhe licencimi, inspektimin dhe kontrollin tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.

- Komiteti i Investimeve Strategjike –Komiteti i Investimeve Strategjike ka këto përgjegjësi:

- a) monitoron funksionimin e sistemit të “dritares unike” për shërbimet ndaj investitorit strategjik;
- b) monitoron performancën e ndikimit të investimeve strategjike e të ecurisë së tyre, si dhe miraton programet konkrete për mbështetjen dhe stimujt për investimet strategjike;
- c) miraton planin e veprimit për masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e një projekti investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit;
- ç) miraton projektet me statusin “*projekt me potencial strategjik*”.

Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

- Risqet mund të jenë disa: vonesa në miratimin e ligjit apo e akteve nënligjore në zbatim të tij;
- vonesa në zbatimin e legjislacionit nga ana institucioneve zbatuese të tjera;
- subjektet privatë zbatues të ligjit;
- mungesa e teknologjisë sipas kërkesave specifike të kërkuara;
- mungesa e profesionistëve të fushës;
- vonesat në miratimin e projekteve strategjike për shkak të burokracisë;
- kundërshtimet nga grupet e interesit që mund të kenë përfitime nga status quo-ja;
- vështirësi në sigurimin e fondeve për modernizimin e infrastrukturës dhe trajnimin e fermerëve.

Një pengesë tjetër e mundshme mund të jetë që strukturat ekzistuese mbikëqyrëse dhe zbatuese mund të mos jenë mjaftueshëm të pajisura ose të trajnuara për të monitoruar zbatimin e standardeve të reja. Operatorët më të vegjël dhe fermerët me burime të kufizuara mund të përballen me vështirësi më të mëdha krahasuar me operatorët më të mëdhenj ose ata që tashmë punojnë me standarde ndërkombëtare. Operatorët dhe institucionet mund të kenë vështirësi në përshtatjen e praktikave të tyre me standardet specifike të BE-së, për shkak të mungesës së përvojës ose ekspertizës teknike.

Të gjitha këto mund t'i vonojnë efektet e pritshme pozitive të ligjit, por gjithsesi nuk e ndalin zbatimin e tij të plotë në të ardhmen.

Disa nga masat që do të ndërrmeren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës janë:

- Sigurimi i paisjes me aftësitë profesionale të specialistëve të stafit administrativ për njohjen dhe zbatimin e dispozitave të reja lidhur me metodat inovative që do të përdoren në bujqësi;
- Mundësia e ofrimit të trajnimeve për fermët për t'u njohur me metodat e reja që do të zbatohen, infrastrukturës teknologjike, përfitimet e konsiderueshme që vijnë si pasojë e zbatimit të këtyre dispozitave ligjore, llojet e aktiviteteve bujqësore që do të zhvillohen në tokat bujqësore, investimet strategjike etj.;
- Forcimi i bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes vendore dhe lokale lidhur me zbatimin sa më të drejtë dhe në kohë të ndryshimeve ligjore sipas këtij propozimi;
- Përcaktimi i kriterëve të qarta për dhënien me qira të tokave;
- Zhvillimi i programeve të trajnimit për fermerët dhe operatorët e biznesit;
- Nxitja e partneriteteve publiko-private për investime në infrastrukturë.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatueshmërisë së opsionit të preferuar do të kryhet nga Drejtoria përgjegjëse monitorimin e kontratave pjesë e strukturë strukturës organike të Ministrisë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si institucion përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave për tokat bujqësore në administrim të saj si dhe AREBET si institucione varësie të MBZHR më disa të drejta mbi tokat bujqësore.

Me qëllim monitorimin efikas dhe vlerësimin e zbatueshmërisë së opsionit të preferuar, MBZHR bashkëpunon edhe me bashkitë, këshillat e qarqeve, prefekturat dhe strukturat e tjera të ngarkuara nga ligji në fuqi.

Për të matur arritjen e objektivave të programeve të çrrënjësjes dhe për të siguruar një proces të efektshëm monitorimi, kriteret e matjes duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë (SMART). Më poshtë paraqiten disa prej tyre:

1. Raportet periodike dhe përfundimtare: Sigurojnë një analizë të detajuar mbi progresin dhe rezultatet e programeve;
2. Treguesit e performancës: Ndihmojnë në matjen e progresit në krahasim me objektivat e vendosura;
3. Numri i kontratave të reja të qirasë që janë nënshkruar për tokat bujqësore me teknologji të avancuara (akuaponia, hidroponia, etj.);
4. Përqindja e tokave bujqësore që janë dhënë me qira për aktivitete inovative krahasuar me totalin e tokave të disponueshme;
5. Vlera totale e investimeve në sektorin e bujqësisë dhe energjisë së rinovueshme, duke përfshirë investitorët strategjikë;
6. Numri i projekteve të financuara që implementojnë teknologji të reja në bujqësi;
7. Rritja e rendimentit për hektar për kulturat bujqësore që përdorin teknologji të reja;
8. Shtimi i prodhimit të produkteve organike dhe përqindja e tyre në totalin e prodhimeve bujqësore;
9. Numri i vendeve të reja të punës të krijuara në sektorët e bujqësisë së avancuar dhe energjisë së rinovueshme;
10. Përqindja e punonjësve të trajnuar në teknologjitë e reja dhe metodologjitë bujqësore;
11. Reduktimi i përdorimit të plehrave kimike dhe pesticideve, duke monitoruar sasinë e përdorur për hektar;
12. Përmirësimi i cilësisë së ujit dhe tokës në zonat e prekura nga projektet bujqësore.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milion lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktorizbritës										
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										

Kosto e zbriturnë total = Kosto në total x faktorinzbritës										
Përfitimipërbuxhetin – nëvazhdim										
Përfitimipërbiznesin – njëherë										
Përfitimipërbiznesin – nëvazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimiizbriturnë total = Përfitiminnë total x faktorinzbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milion lekë		Vlera aktuale neto në milion lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			